

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5543
E premte, 3 gusht 2018
çmimi 0.40 €

Thaçi: Partneriteti
institucione - biznese,
parakusht për suksesin
e Kosovës | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMUSH TAHIRI | FAQE 4-5

Korrigjimi i kufirit me Serbinë, pas pranimimit të Kosovës në OKB

Politologu Ramush Tahiri e ka vlerësuar të rrezikshme idenë që të diskutohet me Serbinë për korrigjim të kufirit para se të ndodhë njohja reciproke në mes të dy shteteve. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se Serbia kufirin me Kosovën duhet ta njohë si kufi shtetëror, pastaj mund të bisedohet për korrigjim të vijës kufitare. Ai ka shprehur besimin e tij se bashkësia ndërkombëtare nuk do ta përkrahë ndarjen apo shkëmbimin e territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, në këtë mënyrë do të pranohet teoria fashizoide, se shqiptarët dhe serbët nuk mund të jetojnë me njëri-tjetrin



AKTUALE

POLICISË I NDALOHET
SHKUARJA NË PUSHIME | F. 11

STATUTI I ASOCIACIONIT,
I GATSHËM PËR DISKUTIME
NË BRUKSEL | F. 6

ORCA: 72 PËR QIND E
PROFESORËVE NUK
I JUSTIFIKOJNË TITUJT E
TYRE AKADEMIKË | F. 6

EKONOMI

PUNËTORËT E KEDS-it
PARALAJMËROJNË GREVË
TË PËRGJITHSHME | F. 8

OEAK-u: PROJEKTILIGJI
PËR PAGAT RREZIKON
QËNDRUESHMËRINË
BUXHETORE | F. 9

HOTI I LDK-SË: QEVERIA
HARADINAJ PO DISKRIMINON
BUJQIT | F. 8

SPORT

GASHI: KOSOVA TË
PREZANTOHET ME DINJITET
NË GARAT NDËRKOMBËTARE | F. 14

FFK-ja VENDOS SISTEMIN
DIGJITAL NË SUPERLIGË | F. 14

Opozita kundërshton idetë për shkëmbim të territoreve | FAQE 3

Përfaqësuesit e subjekteve opozitare i kanë kundërshtuar idetë për shkëmbim të territoreve në kuadër të procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ata kanë thënë se deklaratimet për shkëmbim të territoreve dhe korrigjim të kufijve, ndonëse janë të kota, po i kushtojnë Kosovës me ndërprerje të njohjeve të reja. Sipas opozitës, Kuvendi duhet të ndërpresë pushimin për shkak të procesit të dialogut me Serbinë, meqë Kosova ndodhet në një fazë të rëndësishme ku po diskutohet rreth skenarëve të rrezikshëm me të cilët mund të përballet vendi gjatë dialogut



KDI-ja: Sesioni pranveror i Kuvendit, i paorganizuar dhe me mungesë të kuorumit | FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Britania: Kosova e rëndësishme, por fokusi te çështjet më aktuale

BEOGRAD, 2 GUSHT - Qëndrimi i Britanisë, si kryesuese e radhës e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, është që ky mekanizëm të përqendrohet në çështjet më aktuale që kërcënojnë paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, tha për agjencinë "FoNet" Ambasada e Britanisë në Beograd, duke sqaruar se kjo nuk do të thotë se Kosova nuk ka rëndësi. Britania e Madhe, e cila mban presidencën e Këshillit të

Sigurimit gjatë muajit gusht, nuk e ka futur Kosovën në agjendën e këtij organi të OKB-së. "Kosova është çështje shumë e rëndësishme rajonale evropiane, porse intensiteti i problemit nuk është i njëjtë sikur para 15 vjetësh apo më shumë, andaj nuk ka nevojë për takime të shpeshta, ashtu si Birmania apo Jemeni", tha Ambasada e Britanisë në Beograd, transmeton Shërbimi i Ballkanit i "Radios Evropa e Lirë".

Që nga paslufta në Kosovë Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka diskutuar rregullisht raportet e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së mbi situatën në Kosovë dhe punën e misionit të OKB-së atje, UNMIK. Seanca e fundit e tillë është mbajtur më 14 maj. Derisa Kosova konsideron se këto takime nuk janë më të nevojshme, Serbia thotë se Kombet e Bashkuara do të duhet të diskutojnë për situatën në Kosovë, siç kanë bërë deri më tash.



Talat Xhaferi kërkon mbështetje për referendumin

Në fjalimin e tij me rastin e kremtimit të Ditës së Republikës, kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, tha se Republika e Maqedonisë, dhe të gjithë ne si qytetarë, jemi pranë një vendimi i cili është përcaktues për të ardhmen, nëse do të vazhdojmë drejt integritetit ose do të ngecim në rrethin e verbër ballkanik i cili nuk na çon askund



SHKUP, 2 GUSHT - Republika e Maqedonisë, dhe të gjithë ne si qytetarë, jemi pranë një vendimi i cili është përcaktues për të ardhmen, nëse do të vazhdojmë drejt integritetit ose do të ngecim në rrethin e verbër ballkanik i cili nuk na çon askund - porositi kryetari i Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, para monumentit të Metodi Andonov Cento në Shkup, në fjalimin e tij me rastin e kremtimit të Ditës së Republikës. Në fjalimin e tij Xhaferi porositi opozitën që të marrë përgjegjësi. "Qeveria aktuale dhe shumica parlamentare kanë treguar se janë të gatshëm të marrin përgjegjësi. Nga këtu i bëj thirrje opozitës të marrë pjesë në përgjegjësinë që i përket për të ardhmen e shtetit dhe të qytetarëve. Sot derisa shënojmë Ilindenin do të doja të apeloja deri te të gjithë qytetarët, të gjithë liderët e partive politike dhe kolegët e mi deputetë, që të jenë me të vërtetë të përgjegjshëm dhe vizionarë dhe me fuqinë e votës së tyre ta mbështesin

plotësimin e marrëveshjes që do ta përmbushë qëllimin strategjik drejt BE-së dhe NATO-s. Kjo është detyra jonë për të gjithë ata që luftuan për Maqedoninë. Brezat e ardhshëm meritojnë të jetojnë në Maqedoninë evropiane", tha Xhaferi. Edhe në ditën e përvjetorit të Ilindenit pushteti dhe opozita të ndarë sa i përket marrëveshjes me Greqinë dhe referendumin. Derisa shumica bën thirrje për mbështetje të referendumin, opozita dëshiron anëtarësim në BE dhe NATO pa ndryshuar, sipas tyre, emrin dhe identitetin. Kryeministri Zoran Zaev bëri thirrje që më 30 shtator të përcaktohem për të ardhmen dhe jo për kthim mbrapa. "Ju bëj thirrje të gjithë juve që me krenari të thoni PO që t'i kapim shanset që na i ofron BE-ja. T'i themi PO stabilitetit dhe sigurisë së garantuar përmes anëtarësimit në NATO. T'i themi PO identitetit, gjuhës dhe kulturës maqedonase si të njohur dhe të vërtetuar", tha kryeministri

Zoran Zaev. Kurse lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski, akuzoi pushtetin për veprime të dhunshme dhe montime të rasteve gjyqësore me qëllim përçarjen e këtij subjekti. "Për çfarë uniteti flasim kur me dhunë dhe pa konsultime imponojnë pyetje të

referendumin për ndryshimin e emrit, kur çdo ditë shpallin tradhtar dhe patriot, kur ka deputet dhe viktime të tjera të pafajshëm të ngarkuara me raste të montuara politike me të vetmin qëllim që të përçahet VMRO-DPMNE-ja dhe mosnënshtrimi i popullit

maqedonas", tha Hristijan Mickoski, kryetar i VMRO-DPMNE-së. Referendumi për marrëveshjen me Greqinë është caktuar për 30 shtator. Në rast se nuk arrihet konsensusi, kryeministri Zaev paralajmëroi se procesi kalon në duart e institucioneve.

Vettingu përplas Ramën e Bashën

TRANË, 2 GUSHT - Kryetarët e dy partive më të mëdha në vend kanë thumbaruar njëri-tjetrin përmes rrjeteve sociale lidhur me ecurinë e vettingut. Për kryeministrin Edi Rama gjyket e vettingut

po prishin folenë e gjarpërinjve, por kreu i PD-së, Lulzim Basha, shkruan se vettingu është kapur nga kryemafiozi që mban në detyrë gjyqtarë me lidhje kriminale.

Rama: "Ai momenti kur gjyket e vettingut ta prishin folenë e gjarpërinjve në Pallatin e Drejtësisë. Basha: Rama, Xhafajt, Roshi, Tahiri, Dako, Veliaj, Sejdini, Frrokët & co, kjo bandë kriminale

do t'i ikë drejtësisë sa kohë vettingu i kapur nga kryemafiozi mban gjyqtarë me lidhje kriminale si Dvorani-Hallunaj. Por, gjarpërinjve kokat do t'u shtypen. Nëse jo nga drejtësia, nga populli!"



Opozita kundërshton idetë për shkëmbim të territoreve

Përfaqësuesit e subjekteve opozitare i kanë kundërshtuar idetë për shkëmbim të territoreve në kuadër të procesit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ata kanë thënë se deklarimet për shkëmbim të territoreve dhe korrigjim të kufijve, ndonëse janë të kota, po i kushtojnë Kosovës me ndërprerje të njohjeve të reja. Sipas opozitës, Kuvendi duhet ta ndërpresë pushimin për shkak të procesit të dialogut me Serbinë, meqë Kosova ndodhet në një fazë të rëndësishme ku po diskutohet rreth skenarëve të rrezikshëm me të cilët mund të përballet vendi gjatë dialogut

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 2 GUSHT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, edhe të enjten ka folur për mundësinë e korrigjimit të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ai ka thënë se në kuadër të procesit të dialogut mund të ketë korrigjim të kufijve duke përfshirë Luginën e Preshevës. Presidenti Thaçi ka deklaruar se në asnjë rrethanë, për asnjë çmim dhe nga askush, nuk do të mund të imponohet realizimi i aspiratës serbe për ndarjen e Kosovës. "Sa i përket korrigjimit të kufijve kemi rreth 400 kilometra të kufirit me Serbinë që duhet të shënjohej dhe pa demarkacionin me Serbinë nuk mund të përmbillet procesi i shtetformimit dhe konsolidimit. Për këtë arsye do të diskutohet për demarkacionin, për korrigjimin e kufijve dhe në kuadër të korrigjimit të kufijve, në asnjë rrethanë, për asnjë çmim, nuk do të mund të imponohet realizimi i aspiratës serbe për ndarje të Kosovës. Ndërkaq mendoj se në kuadër të korrigjimit është shumë e realizueshme, e pranueshme nga ana jonë, kërkesa e institucionalizuar e përfaqësuesve të Luginës së Preshevës për t'u bashkuar me Kosovën. Nëse ka marrëveshje ose ka pajtueshmëri të dyanshme askush nuk do të mund dhe nuk do të dalë kundër një marrëveshje të vullnetit të mirë të palëve të përfshira në dialog në këtë rast të Kosovës dhe Serbisë. Pra, as BE-ja, as NATO-ja dhe as ShBA-ja. E rritet se në asnjë rrethanë nuk do të ketë ndarje, korrigjim të kufijve mund të ketë duke përfshirë Luginën e Preshevës", ka deklaruar presidenti Thaçi gjatë një vizite që i ka bërë Odës Ekonomike të Kosovës (OEK).

Thaçi ka paralajmëruar se nga fundi i muajit gusht dhe fillimi i muajit shtator do të ketë një dinamikë më të fuqishme të dialogut Kosovë - Serbi të udhëhequr nga Bashkimi Evropian dhe të mbështetur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndërsa subjektet

opozitare i kanë quajtur të papranueshme deklaratat e presidentit Thaçi për mundësinë e shkëmbimit të territoreve në kuadër të procesit të dialogut me Serbinë. Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë të enjten se lojërat për shkëmbim të territoreve apo korrigjim të tyre janë të kota. "Lojërat me fjalë si 'shkëmbim territorësh' dhe 'korrigjim të kufijve' janë të kota, por po na kushtojnë me stopim të plotë të njohjeve të reja. Kosova është pranuar shtet i pavarur në kufijtë e vitit 1989. Janë mbi 110 vende që na kanë njohur në ata kufij. Opinioni i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë merr parasysh ata kufij dhe bazuar në këtë opinion na kanë njohur shtetet më të fuqishme dhe demokratike të botës. Askush nuk ka të drejtë të diskutojë për territorin e Kosovës, sepse do të binte ndesh me vullnetin e popullit të Kosovës për shtet të pavarur, të shpallur me Deklaratën e Pavarësisë më 17 shkurt 2008, dhe me Kushtetutën e Kosovës", ka deklaruar Hoti, duke shtuar se lojërat me fjalë si "shkëmbim territorësh" ose "korrigjim i kufijve" po e dëmtojnë pozicionin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. "Vetë ideja që kjo çështje mund të diskutohet në dialogun me Serbinë e ka nxjerrë jashtë funksionit të saj gjithë diplomacinë e Kosovës. Sot në asnjë takim apo forum ndërkombëtar nuk diskutohet për njohje të reja që duhet t'i vijë Kosovës, sepse liderët institucionalë të Kosovës kanë dhënë sinjale se do ta rishikojnë tërësinë territoriale të Kosovës. Kjo është e pafalshme dhe do të ndëshkohet nga qytetarët e Kosovës", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Me çështjen e dialogut është marrë të enjten edhe Partia Socialdemokrate, me ç'rast kryetari i saj, Shpend Ahmeti, ka bërë thirrje që Kuvendi ta ndërpresë pushimin për shkak të këtij procesi. Në një konferencë për medie Ahmeti ka thënë se



Kosova aktualisht ndodhet në një fazë shumë të rëndësishme, duke përmendur diskutimet rreth skenarëve të rrezikshëm me të cilët mund të përballet Republika e Kosovës gjatë dialogut me Serbinë. Sipas Ahmetit, përfundimi i sesionit pranveror ka pamundësuar votimin e rezolutës së propozuar nga PSD-ja për dialogun, për të cilën ka thënë se është zgjidhja e vetme për kompromis mes subjekteve politike për një platformë të përbashkët. "E në këtë platformë do të duhej të përfshiheshin strategjia dhe qëllimet që duhet t'i ketë Republika e Kosovës në lidhje me këtë dialog. Gjithashtu, Kuvendi duhet të jetë në krye të këtij procesi

negociator. Duam t'i kujtojmë publikut se Republika e Kosovës është republikë parlamentare, prandaj nuk qëndrojnë argumentet se në njërin anë është Vuçiqi e në anën tjetër Thaçi, sepse ne edhe për nga organizmi politik ndryshojmë nga Republika e Serbisë", është shprehur Ahmeti.

Kurse nënkryetari i PSD-së, Visar Ymeri, ka thënë se Kosova aktualisht nuk ka përfaqësues në procesin e dialogut. Lidhur me këtë, ai ka theksuar se ato që janë folur në takime formale e joformale, të fshehta, nga presidenti Thaçi, nuk vlejnë dhe as nuk janë obligime të Republikës së Kosovës "pasi që këto janë zotime nga një person i cili nuk

ka mandat e as autorizim për ta bërë një gjë të tillë". "Çështja e parë që rezoluta e PSD-së mundohet ta bëjë është që procesit t'i japë legjitimitet. Çështja e dytë është që këtij procesi t'i vendosen disa korniza përbrenda një strategjie dhe platforme të qartë në të cilën Kuvendi i Republikës së Kosovës vendos edhe agjendën edhe kohën e nisjes së negociatave me Serbinë si dhe për kushtet e kërkesat që duhet të shtrohen para fillimit të këtij dialogu", ka deklaruar Ymeri, duke shtuar se legjitimiteti, platforma dhe përfaqësimi duhet të vendosen në Kuvend me votë të kualifikuar, pra me votën e 2/3 të deputetëve.


Haradinaj emëron Rosario Petta këshilltar për çështje të arbëreshëve

PRISHTINË, 2 GUSHT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të enjten ka emëruar kryetarin e komunës Piana degli Albanesi në Sicili, Rosario Petta, këshilltar të jashtëm për çështje të arbëreshëve. Me këtë rast, Haradinaj ka thënë se arbëreshët e Italisë paraqesin ndër rastet më unike dhe mbresëlënëse në historinë botërore. "Pas shumë shekujve kanë arritur t'i ruajnë vlerat sublime të origjinës. Ndjenjë e veçantë të pres Rosario Petta, kryetarin e komunës Piana degli Albanesi në Sicili, të cilin e emërova këshilltar të jashtëm për çështje të arbëreshëve dhe e nderova me medaljen e artë të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, për përkushtimin në ruajtjen e traditave dhe vlerave shumëshekullore të paraardhësve", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Flet për "Epokën e re", Ramush Tahiri

Korrigjimi i kufirit me Serbinë, p



Politologu Ramush Tahiri e ka vlerësuar të rrezikshme idenë që të diskutohet me Serbinë për korrigjim të kufirit para se të ndodhë njohja reciproke në mes të dy shteteve. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se Serbia kufirin me Kosovën duhet ta njohë si kufi shtetëror, pastaj mund të bisedohet për korrigjim të vijës kufitare. Ai ka shprehur besimin e tij se bashkësia ndërkombëtare nuk do ta përkrahë ndarjen apo shkëmbimin e territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, në këtë mënyrë do të pranohej teoria fashizoide, se shqiptarët dhe serbët nuk mund të jetojnë me njëri-tjetrin

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 2 GUSHT - Politologu Ramush Tahiri ka bërë me dije se Kosova nuk duhet të bisedojë me Serbinë për korrigjim të kufirit para se kjo e fundit ta njohë Republikën e Kosovës. Ai ka deklaruar se diskutimi për këtë çështje në këtë fazë të procesit është i rrezikshëm për Kosovën. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Tahiri ka thënë se korrigjimi i kufirit në mes të dy vendeve mund të ndodhë vetëm pasi Kosova të bëhet anëtare e OKB-së. "Pa u pranuar Kosova në OKB dhe pa u pranuar në mënyrë bilaterale nga shtete e tjera,

sikurse janë pranuar Maqedonia dhe Mali i Zi, nuk bën të diskutojë për korrigjim të kufirit. Një herë Kosova duhet të pranojë se e ka një kufi shtetëror me Serbinë dhe si tillë ai duhet të pranohet nga shteti serb, pastaj mund të hyhet në debate të tjera", ka thënë Tahiri. Ai ka kundërshtuar idenë e ndarjes dhe të shkëmbimit të territoreve në mes të dy vendeve. Sipas Tahirit, kjo do të sillte pasojë të rënda për qytetarët e të dy shteteve dhe në këtë mënyrë do të pranohej teoria fashizoide, se shqiptarët dhe serbët nuk mund të jetojnë me njëri-tjetrin. "Mendoj se edhe bashkësia ndërkombëtare nuk është për ndarje ose për këmbim të terri-

toreve. Sepse në këtë mënyrë do të pranohej teoria fashizoide, se ne nuk mund të jetojmë me njëri-tjetrin. Unë konsideroj se shqiptarët dhe serbët mund të jetojnë me njëri-tjetrin dhe si popuj nuk duhet të jemi të armiqësuar", ka thënë Tahiri. Më tej, ai ka vlerësuar se Kosova dhe Serbia mund të ecin përpara vetëm duke respektuar parimin e shtetit qytetar. "Kosova dhe Serbia mund të ecin përpara vetëm duke i pranuar kufijtë ekzistues të tyre. Kosova dhe Serbia mund të ecin përpara vetëm duke i respektuar pakicat që i kanë brenda kufirit të tyre, si shqiptarët ashtu edhe serbët. Në këtë mënyrë Kosova dhe Serbia

mund të ecin përpara duke qenë shtete qytetare e jo duke qenë shtete etnike", është shprehur Tahiri.

"Epoka e re": Z. Tahiri, në forume të ndryshme po debatohet ideja se në fazën finale të dialogut me Serbinë mund të diskutohet ndarja e Kosovës, apo shkëmbimi i territoreve me Serbinë. I shihni të realizueshme këto ide?

Tahiri: Ndarja, apo shkëmbimi i territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, nuk është ide e mirë. Mendoj se duhet të kemi një periudhë të gjatë paqeje dhe mirëkuptimi në mënyrë që t'ua lëmë gjeneratave të ardhshme të vendosin për këto çështje. Sepse ato gjenerata nuk do t'i kenë paragjykimet e kaluara. Konsideroj se në këtë fazë Kosova dhe Serbia duhet ta pranojnë njëra-tjetrën. Kosova duhet të anëtarësohet në OKB, mandej si dy shtete ta relativizojnë kufirin, që ta bëjnë krejt të parëndësishme për qytetarët e dy të vendeve se në cilin shtet jetojnë. Kjo do të ishte ide më e mirë sesa t'i nxjerrim teorinë e së kaluarës, se mirë jetohej vetëm në shtetet

etnike dhe se vetëm kufijtë mund të sigurojnë qetësi. Në rastin e Kosovës dhe Serbisë kufiri etnik është shumë e vështirë të përcaktohet. Sepse kemi mjedise që popullata jeton e përzier, sikurse kemi mjedise në Kosovë që nuk kanë lidhje territoriale, siç është Manastiri i Deçanit, Patrikana e Pejës, Graçanica, Novobërda e disa fshatra të tjera me shumicë serbe. Çdo këmbim ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të prodhonte fatkeqësi dhe shpërngulje të popullatës. Pra, në këtë fazë veprimet e tilla do të shkaktonin pakënaqësi dhe armiqësi për dekada me radhë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

"Epoka e re": Duke qenë të vetëdijshëm për këto pasoja, besoni se bashkësia ndërkombëtare mund ta lejojë realizimin e këtyre ideve?

Tahiri: Mendoj se edhe bashkësia ndërkombëtare nuk është për ndarje ose për këmbim të territoreve. Sepse në këtë mënyrë do të pranohej teoria fashizoide se ne nuk mund të jetojmë me njëri-tjetrin. Unë konsideroj se shqiptarët dhe serbët mund të

as pranimit të Kosovës në OKB



bët. Në këtë mënyrë Kosova dhe Serbia mund të ecin përpara duke qenë shtete qytetare e jo duke qenë shtete etnike.

"Epoka e re": *Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, derisa po e kundërshton ndarjen, po e përmend mundësinë e korrigjimit të kufirit në mes të dy shteteve. Çfarë nënkupton kjo për ju?*

Tahiri: Së pari, Kosova duhet të pranohet si shtet nga Serbia pastaj, në mënyrë të vullnetshme dhe të dyanshme, nëse dëshirojnë, mund të bëjnë edhe korrigjimit të kufirit. Këtë mënyrë të veprimit besoj se e përkrah edhe Evropa. Çështja e terminologjisë, korrigjimit kufiri, ndryshim kufiri, dhe këmbim kufiri mund të jetë e njëjtë ose e ndryshme, varësisht prej opsionit që është në tavolinë. Për shembull, një korrigjimit kufiri ka të bëjë nëse një lumë do të jetë këndeje ose andej kufirit, apo nëse një kodër do të jetë këndeje apo andej. Çështja e korrigjimit të kufijve me opsione që Kosova do ta japë Leposaviqin dhe Leshakun e do të marrë Preshevën e Tërnocin, nuk janë të mira për opinion dhe nuk janë çështje për t'i diskutuar në publik. Ato bisedohen në tavolinë ku duhet të shihet edhe interesi i banorëve që jetojnë në ato vise. Kosova më herët e ka bërë një gabim, ku i ka formuar komunat serbe pa i pyetur banorët e fshatrave se a dëshirojnë të bëhen pjesë e kësaj apo asaj komune. Tani gabimi nuk bën të përsëritet, sepse mund të shkaktohen përsëri pakënaqësi te qytetarët. Mirëpo për Kosovën është e rrezikshme të diskutohet për korrigjimit të kufirit pa e vërtetuar kufirin. Së pari duhet të përcaktohet kufiri administrativ i ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, i garantuar me Kushtetutën e vitit 1974, dhe i pranuar edhe nga Komisioni i Badinterit, i cili thotë se kufijtë administrativë bëhen kufij shtetërorë. Pra, kjo duhet të pranohet nga Serbia, të nënshkruhet marrëveshja se ky kufi administrativ bëhet kufi shtetëror, pastaj komisionet e përbashkëta mund të vendosin se a do të kalojë një fshat këndeje kufirit apo andej. Apo se a do të kthehet gjendja e vitit 1959, ku Kosova i kishte disa fshatra të Preshevës, ndërsa nuk e kishte Leposaviqin dhe Leshakun. Po përsëris edhe një herë, se pa u pranuar Kosova në OKB dhe pa u pranuar në mënyrë bilaterale nga shtetet e tjera, sikurse janë pranuar Maqedonia dhe Mali i Zi, nuk bën të diskutojë për korrigjimit të kufirit. Një herë Kosova duhet të pranohet se e ka një kufi shtetëror me Serbinë dhe, si tillë, ai duhet të pranohet nga shteti serb, tek pastaj mund të hyhet në debate të tjera.

"Epoka e re": Pra, këto ide nuk mund t'u sigurojnë dy shteteve perspektivë të sigurt?

Tahiri: Kosova dhe Serbia mund të ecin përpara vetëm duke i pranuar kufijtë ekzistues të tyre. Kosova dhe Serbia mund të ecin përpara vetëm duke i respektuar pakicat që i kanë brenda kufirit të tyre, si shqiptarët ashtu edhe ser-

"Epoka e re": *Përmendja e Luginës së Preshevës nga presidenti nga shumë opinionistë është parë edhe si lojë e tij?*

Tahiri: Presidenti Thaçi e fut në lojë Luginën e Preshevës për faktin se edhe Vuçiqi po i fut në lojë serbët e Kosovës. Pra, është e drejtë e të dy presidentëve që të flasin për pakicat kombëtare që i kanë në shtetet e tyre.

"Epoka e re": *Ka një kohë që shoqëria e Kosovës po debaton rreth fazës finale të dialogut me Serbinë. A po përgatiten si duhet institucionet tona për këtë fazë të procesit?*

Tahiri: Fatkeqësisht, Kosova nuk po i përgjigjet mirë kësaj faze të dialogut. Derisa në Serbi ka një farë uniteti për këtë çështje, në Kosovë nuk ka. Ani pse në Serbi ka unitet funksional, sepse partia e Vuçiqit e ka marrë shumicën dërrmuese në Kuvend, te ne koalicioni qeverisës nuk e ka atë shumicë, plus është i varur prej Listës Serbe. Atë që unë si

politolog e shoh si mangësi, është se ne nuk e kemi një platformë për këtë fazë të dialogut, e cila do të duhej të miratohej në Kuvend.

"Epoka e re": *Çfarë do të duhej të përmbajë një platformë e tillë?*

Tahiri: Ajo platformë mund të jetë shumë e thjeshtë. Pika e parë e kësaj platforme duhet të jetë se Kosova hyn në bisedime me Serbinë si shtet sovran, i pavarur dhe i barabartë. Së dyti, se Kosova në këtë proces do ta respektojë Kushtetutën dhe ligjet e saj në përpikëri. Së treti, Kosova në këtë fazë do ta respektojë vullnetin e popullit të saj dhe synimet afatgjatë për integritet evropian dhe euroatlantike. Së katërti, do të duhej të ceket se çdo marrëveshje që do të nënshkruhet në Bruksel do të ratifikohet në Kuvend me dy të tretat e votave. Dhe, së pesti, do të duhej të ceket se bisedimet politike do t'i udhëheqë presidenti i vendit si figurë unifikuese. Meqenëse unë kaq thjesht i përmenda këto pesë pika, edhe

presidenti ose Qeveria ka mundur ta prezantojë një platformë të tillë në Kuvend. Sepse pa kaluar në Kuvend një dokument i tillë, nuk mund të krijohet uniteti.

"Epoka e re": *Po reagimin e opozitës për këtë fazë të dialogut, si e keni parë?*

Tahiri: Tani për tani opozita nuk ka një dokument bazë për këtë proces. Ne mund ta kritikojmë atë, por meqenëse nuk ka ndonjë dokument bazë të pushtetit për këtë çështje, është normale që ajo të kritikojë. Këtë argument opozitës mund t'ia heqë pushteti, nëse e çon një dokument në Kuvend me këto pikat që i përmenda më lart. Natyrisht se pajtohem që opozita po luan lojë politike, sepse ajo në këtë mënyrë dëshiron të fitojë tek elektorati dhe dëshiron ta zhveshë Qeverinë. Mirëpo në këtë moment Qeveria dhe presidenti po i ndihmojnë opozitës, ngaqë nuk po e bëjnë shumë hesap dhe nuk po i ofrojnë ndonjë platformë për këtë proces.

Majko, Gjuriqit: Ëndrrat për ndryshim të kufijve kanë mbaruar

PRISHTINË, 2 GUSHT - Ish-kryeministri i Shqipërisë, Pandeli Majko, ka thënë se ëndrrat për ndryshim të kufijve kanë përfunduar përfundimisht. Kjo deklaratë e Majkos ka ardhur si reagim ndaj deklaratës së Marko Gjuqirit, i cili ka thënë se Kosova dhe Shqipëria nuk kanë kufij. "Dje kryeministri Haradinaj më kërkoi që në festimet ku ishim të ftuar, bashkë me presidentin

Hashim Thaçi dhe zëvendëskryeministrin Pacolli dhe Gashi, në Komunën e Skenderajt, nën hijen e bustit të Bacës Adem Jashari, të isha unë që do ta jepja lajmin se Kosova e ka marrë vendimin përfundimtar për lëvizjen e lirë midis kufijve shtetërorë të dy vendeve tona. Lexova që sot, Gjuriqi, drejtori i Zyrës për Kosovën në shtetin e Serbisë, ka deklaruar se 'Kosova

dhe Shqipëria nuk kanë kufij, ekziston vetëm kufiri ndërmjet Serbisë e Shqipërisë me gjatësi 111 kilometra'. Uroj që dikush t'i thotë se Jugosllavia nuk ekziston më. Ëndrrat me ndryshim të kufijve kanë mbaruar përfundimisht. Kosova është shtet i pavarur dhe kjo është arsyeja pse edhe ai është sot drejtor. Natyrisht", ka shkruar Majko në llogarinë e vet në "Facebook".



Statuti i Asociacionit, i gatshëm për diskutime në Bruksel

Shefi i ekipit teknik të Kosovës në dialogun me Serbinë, Avni Arifi, ka bërë me dije se drafti fillestar i Statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe do të jetë i gatshëm për diskutim në Bruksel deri nesër (e shtunë). "Në bazë të informacioneve krejt anësore që i kam, flitet se ekipi menaxhues e ka përgatitur draftin i cili edhe ashtu është dashur të përfundojë para datës 4 gusht, por presim që deri më 4 gusht ekipi menaxhues ta dorëzojë atë në Bruksel", ka theksuar Arifi

PRISHTINË, 2 GUSHT - Drafti i parë i Statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe pritet të jetë gati deri më 4 gusht, kur ekipi menaxhues i formuar për këtë çështje pritet ta dërgojë atë në Bruksel. Kështu ka thënë për "Radion Evropa e Lirë", Avni Arifi, shefi i ekipit teknik të Kosovës në dialogun me Serbinë. Por, Arifi thotë se ky ekip menax-

hues, në bazë të një marrëveshjeje të mëhershme në Bruksel, ka një privatësi të plotë në punë, kështu që edhe Qeveria e Kosovës është privuar nga mundësia e marrjes së më shumë informacioneve. "Ekipi menaxhues, i cili ka qenë i caktuar ta fillojë draftimin e statutit, e ka pasur një pavarësi që, faktikisht, hartuesit e marrëveshjes në vitin 2014 apo

2015 i kanë dhënë aq shumë liri saqë nuk kanë qenë të obliguar për të dhënë informacion. Por, në bazë të informacioneve krejt anësore që i kam, flitet se ata e kanë përgatitur draftin i cili edhe ashtu është dashur të përfundojë para datës 4 gusht, por presim që deri më 4 gusht ekipi menaxhues ta dorëzojë atë në Bruksel", ka theksuar Arifi.

Ekipi menaxhues i cili është krijuar për ta hartuar statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe përbëhet vetëm nga pjesëtarë të komunitetit serb. Ky ekip ka nisur punën që nga muaj prill i këtij viti. Ndërkohë, përfaqësuesit e ekipit menaxhues, pas një takimi që kanë zhvilluar të mërkurën me shefin e misionit të OSBE-së, Jan Braathu në Kosovë, kanë deklaruar se janë të gatshëm që draftin t'ua prezan-

tojnë instancave të larta politike në Bruksel. Ndërsa ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal në Qeverinë e Kosovës, Ivan Todosojeviq, ka deklaruar ditë më parë se, pavarësisht çfarë thonë në kabinetin e kryeministrit Ramush Haradinaj se nuk kanë informata, në Qeveri është raportuar vazhdimisht në lidhje me këtë proces. "Pres që ekipi drejtues ta hartojë statutin, ashtu siç është përcaktuar me marrëveshjet në Bruksel", ka deklaruar ai. Themelimi i Asociacionit apo Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe është produkt i marrëveshjeve të Brukselit, të arritura në kuadër të dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit me lehtësimin e Bashkimit Evropian. Me draftin e statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe,

sipas Arifit, duhet të pajtohet edhe pala e Kosovës dhe ajo serbe, si dhe duhet të pajtohen edhe grupet e tjera që janë të paraparë me marrëveshjen e Brukselit. Draftstatuti për Asociacionin, shton Arifi, do të jetë një dokument publik ku do të krijohet hapësirë edhe për shoqërinë civile, edhe për qytetarë që të shprehen lidhur me përbajtjen dhe ecurinë e aprovimit të Asociacionit. Po ashtu, nënvizon ai, statuti për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe më pas do të dërgohet edhe në Gjykatën Kushtetuese për interpretim. "Janë disa procedura deri në dërgimin në Gjykatën Kushtetuese. Procedura e parë është të shkohet në Bruksel. Do të bisedojmë, por është pjesë e marrëveshjes së Brukselit që edhe drafti i statutit, edhe dekreti i statutit të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese dhe të shikohet a është në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo në çdo variant do të ndodhë kur t'i vijë koha", është shprehur Arifi.

Formimi i Asociacionit të Komunave Serbe nga Beogradi zyrtar dhe përfaqësuesit e serbëve të Kosovës shihet si çështja kyçe në bisedimet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel. Ndërsa institucionet e Kosovës po këmbëngulin për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura, të cilat, sipas Prishtinës, janë bllokuar nga Beogradi. Para së gjithash, përmenden marrëveshjet për energjinë, ajo për hapjen e urës mbi lumin Ibër, kthimi i dokumenteve kadastrale, njohja e diplomave dhe lejimi i funksionimit të objekteve të marra me qira në veri. Kurse pala serbe insiston në formimin sa më të shpejtë të Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe.



ORCA: 72 për qind e profesorëve nuk i justifikojnë titujt akademikë

Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) ka prezantuar të enjten një analizë për pensionimin e stafit akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", specifikisht për profesorët e rregullt që nuk justifikojnë titujt e tyre akademikë. Sipas kësaj organizate, 72 për qind e profesorëve nuk i justifikojnë titujt që kanë. "Ajo që ne ngritëm si shqetësim të veçantë ishte rasti i 122 profesorëve të rregullt, të cilët mbajnë titullin më të lartë akademik dhe, si rrjedhojë, kanë kontratë me kohë të pacaktuar. Nga 122 profesorët e rregullt që nuk justifikojnë titujt e tyre akademikë,

36 supozohen të pensionohen në vitin 2018, por deri tani janë pensionuar vetëm 16. Profesori i fundit i rregullt që nuk e justifikon titullin e tij do të pensionohet në vitin 2036. Kjo do të thotë se fëmijët që aktualisht janë tre vjeçar do të mund të mentorohen në temat e tyre të diplomës në nivelin bachelor te ky profesor; fëmijët aktualisht pesëvjeçar do të mund të mentorohen në nivelin master nga po ky profesor, ndërsa dikush nga fëmijët aktualisht 10-vjeçar mund ta ketë fatin të mentorohet në doktoraturën e tij/saj nga profesori në fjalë", është thënë në njoftimin e ORCA-s.



Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar rezultatet e monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për sesionin pranveror

KDI-ja: Sesioni pranveror i Kuvendit, i paorganizuar dhe me mungesë të kuorumit

Sesioni pranveror i punës së Kuvendit të Kosovës është karakterizuar me mungesa të theksuara të deputetëve në votim dhe mosorganizim të duhur të punimeve. Kështu ka deklaruar përfaqësuesi i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Artan Murati, të enjten në një konferencë për medie, gjatë prezantimit të raportit për monitorimin e punës së Kuvendit për sesionin pranveror. Ai ka thënë se gjatë kësaj periudhe Kuvendi nuk ka qenë efikas në organizimin dhe menaxhimin e punimeve të tij. Murati ka treguar se gjatë këtij sesioni Kuvendi ka arritur t'i miratojë 33 ligje, 55 projektligje janë në procedurë dhe 59 të tjera në pritje

EPOKA
ERE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 2 GUSHT - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) të enjten ka publikuar të gjeturat nga monitorimi i punës së Kuvendit të Kosovës për sesionin pranveror. Me këtë rast, Artan Murati nga KDI-ja, në një konferencë për medie, ka thënë se kjo periudhë është karakterizuar me mungesa të theksuara të deputetëve në votim dhe mosorganizim të duhur të punimeve. "Janë 20 nga gjithsejtë 27 seancat e mbajtura gjatë periudhës janar-korrik që kanë vazhduar punimet në ditë të tjera për shkak të numrit të madh të pikave të rendit të ditës dhe mungesës së kuorumit. Kuvendi nuk ka qenë efikas në organizimin dhe menaxhimin e punimeve të tij. Thirrja e seancave të reja pa përfundimin e seancave paraprake ka ndikuar në grumbullim të pikave të papërfunduara të rendit të ditës dhe në efikasitetin e punës së Kuvendit", ka deklaruar ai.

Murati ka thënë se karakteristikë e këtij sesioni të punës së Kuvendit është mungesa e theksuar e pjesëmarrjes në votim nga deputetët dhe, sipas tij, kjo ka prodhuar ngecje në funksionin ligjvënës të Kuvendit duke limituar në masë të madhe numrin e projektligjeve të miratuara, përfshirë këtu edhe dështimin e ratifikimit të disa marrëveshjeve ndërkombëtare me rëndësi të veçantë për qytetarët e vendit. "Vlen të theksohet se përbushja e agjendës legislative për vitin 2018 deri tani është 22%. Mungesa e deputetëve në votim nuk përbën shqetësimin e vetëm. Deputetët kanë munguar jo vetëm në seanca plenare, por edhe në mbledhjet e komisioneve parlamentare. Gjatë sesionit pranveror janë evidentuar 660 mungesa, praktikë kjo që bie në kundërshtim me obligimet e deputetëve për

pjesëmarrje në punimet e Kuvendit", ka theksuar ai, duke shtuar se KDI-ja u bënë thirrje subjekteve politike parlamentare ta trajtojnë dhe rregullojnë këtë çështje përmes Rregullores së Punës së Kuvendit dhe deputetët që mungojnë në seanca, e sidomos në votim, të penalizohen. "Mospjesëmarrja në seanca dhe në votim është shmangie nga përgjegjësia dhe përfaqësimi i qytetarëve. Për deputetët që nuk marrin pjesë në votim duhet të parashihen ndëshkime jo vetëm me votë, por edhe financiare", ka thënë Murati. Ai ka treguar se edhe pse me tre muaj vonesë, Kuvendi në këtë legjislaturë për herë të parë e ka miratuar planin e punës për vitin 2018. Sipas Muratit, në sesionin pranveror Kuvendi ka arritur t'i miratojë 33 ligje, 55 projektligje janë në procedurë dhe 59 të tjera në pritje. "Agjenda legislative e Kuvendit përfshin 135 projektligje, 22 nga të cilat janë bartur nga viti i kaluar. Në ndërkohë, agjendës legislative i janë shtuar edhe 13 projektligje të tjera që më herët nuk kanë qenë të parapara, duke rritur numrin në 148 projektligje të planifikuara për shqyrtim këtë vit. Për sesionin pranveror Kuvendi ka arritur të miratojë 33 ligje, ndërsa në komisionet parlamentare në procedurë për shqyrtim janë edhe 55 projektligje (38%). Janë 59 projektligje ose (40%) që nuk janë përgatitur ende. Kuvendi ka vazhduar praktikën e shqyrtimit të projektligjeve në procedurë të përsheptuar, ku gjatë këtij sesioni 11 nga ligjet e miratuara janë shqyrtuar me procedurë të përsheptuar", ka potencuar Murati.

Ai ka vlerësuar se për dallim prej legjislaturës së kaluar, kjo legjislaturë qëndron më mirë në planin mbikëqyrës. Murati ka treguar se gjatë këtij sesioni janë parashtruar gjithsejtë 237 pyetje parlamentare. "Grupi

parlamentar më aktiv me pyetje është ai i Vetëvendosjes me 79 pyetje, pasuar nga LDK-ja me 64 pyetje, PDK-ja me 34 pyetje, PSD-ja me 31 pyetje, AAK-ja me 14 pyetje, Nisma me 13 pyetje, Lista Serbe me 1 pyetje, Grupi 6+ me 1 pyetje, dhe 1 pyetje nga deputeti pa grup parlamentar, Slobodan Petroviq. Pavarësisht prej numrave, 61 deputetë nuk kanë parashtruar asnjë pyetje parlamentare", është shprehur ai, duke shtuar se ka rritje të numrit të interpelancave, gjithsejtë 12 interpelanca në këtë sesion. Megjithatë, pavarësisht prej numrit të madh të interpelancave, Murati ka thënë se nuk është arritur ndonjë efekt konkret. "Në shumicën e rasteve interpelancat janë

zhvilluar shumë më vonë sesa koha e parashtrimit të kërkesës për interpelancë nga grupet parlamentare. Për më tepër, interpelancat zakonisht janë thirrur për çështje veçse të ngritura nga opinioni publik, pra deputetët nuk u kanë paraprirë këtyre temave, por kanë reaguar pas reagimit të opinionit publik", ka deklaruar Murati. Më tutje, ai ka treguar se gjatë sesionit pranveror komisionet parlamentare kanë ftuar për raportim 38 herë ministrat e kabinetit qeveritar. Por, sipas Muratit, Kuvendi shpeshherë është shpërfillur nga ana e ekzekutivit, pasi ky sesion është karakterizuar me pjesëmarrje shumë të vogël të kabinetit qeveritar në seanca plenare. Po ashtu, ai ka bërë me dije se

Kuvendi ka stagnuar në monitorimin e zbatimit të ligjeve. Përgjatë sesionit pranveror të punës, Kuvendi ka miratuar vetëm një raport të monitorimit të zbatimit të ligjit. Murati ka thënë se edhe në raport me transparencën financiare, Kuvendi ka shënuar regres, duke mos publikuar asnjë raport financiar për shpenzimet e realizuara gjatë periudhës janar-qershor të këtij viti. "Ky kthim prapa për përbushjen e transparencës dhe praktikave të mira të qeverisjes është i papranueshëm, sidomos duke u bazuar në faktin se në vitet paraprake raportet mbi shpenzimet e Kuvendit janë publikuar në mënyrë periodike, çdo tre muaj", është shprehur Murati.

Pak deputetë presin bashkatdhetarët

PRISHTINË, 2 GUSHT - Dyert e Kuvendit të Kosovës janë hapur të enjten për bashkatdhetarë, të cilët kanë shprehur interesimin për të parë nga afër hapësirat ku deputetët zhvillojnë veprimtarinë e tyre. Për shkak të përfundimit të sesionit pranveror, numri i deputetëve që kanë pritur bashkatdhetarët ka qenë i vogël.

Deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, u ka bërë thirrje kolegëve të saj të vijnë në Kuvend për t'i mirëpritur bashkatdhetarët. "E keni parë paralajmërimin që ka qenë prej orës 10:00. Kuvendi nga e hëna ka shkuar në pushim. Deputetët që janë këtu së pari do të vijnë t'i takojnë bashkatdhetarët. Unë mora një libër nga Halit Elshani, nga një bashkatdhetar që jeton



në Bruksel, i cili ka punuar gjatë atje për t'i integruar fëmijët e tij dhe për t'i kthyer në Kosovë", ka deklaruar Musliu. Ndërsa bashkatdhetari Halit Elshani nga Belgjika, i cili ka vizituar Kuvendin, ka thënë se

gjendja në Kosovë nuk është e keqe sa thuhet. Për t'u takuar me bashkatdhetarë ka ardhur edhe deputeti i LDK-së, Armend Zemaj. Ai ka thënë se në Kosovë nuk janë realizuar pritjet e bashkatdhetarëve.

Hamza merr mbështetje nga deputeti gjerman për fushën e financave publike

PRISHTINË, 2 GUSHT - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka prit-ur në takim deputetin e Bundestagut të Republikës Federale të Gjermanisë, Volkmar Klein, i cili ka qenë i shoqëruar nga ambasadori gjerman në Prishtinë, Christian Heldt. Në këtë takim Hamza dhe deputeti gjerman kanë diskutuar për progresin të cilin e ka arritur Kosova gjatë këtyre muajve në fushën e financave publike. Me këtë rast, Hamza e ka vlerësuar lart vizitën e deputetit gjerman në Kosovë, si dhe në emër të shtetit të Kosovës ka falënderuar shtetin gjerman për ndihmën dhe



bashkëpunimin e vazhdueshëm që ka me Kosovën. Më tutje, ministri Hamza e ka njoftuar deputetin gjerman Volkmar Klein për progresin e arritur në Kosovë, sidomos për stabilitetin

makrofikal të vendit, si dhe për reformat e deritanishme tati-more, në drejtim të krijimit të një ambienti të favorshëm të operimeve biznese në Kosovë, në mënyrë që Kosova të jetë sa më tërheqëse për investime të huaja duke përfshirë edhe ato gjermane. Hamza ka thënë se ndihma e vazhdueshme e Qeverisë gjermane ka ndikuar drejtpërdrejt edhe në përmirësimin e standardit dhe të kualitetit të jetës të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ndërsa deputeti i Bundestagut të Republikës Federale të Gjermanisë, Volkmar Klein, ka vlerësuar lart

angazhimin e Ministrisë së Financave, stabilitetin makrofikal dhe treguesit e tjerë ekonomikë e financiarë të vendit, si dëshmi e punës me përkushtim, përgjegjshmëri dhe profesionalizëm. Ai është shprehur i lumtur lidhur me efektin pozitiv të ndikimit të projekteve të Qeverisë gjermane për shtetin dhe qytetarët e Kosovës. Deputeti Klein ka shprehur gatishmërinë e shtetit gjerman për thellimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit dhe ofrimin e ndihmës për Kosovën për realizimin e planeve strategjike në fushën e financave publike.

Hoti i LDK-së: Qeveria Haradinaj po diskriminon bujqit

PRISHTINË, 2 GUSHT - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka kritikuar Qeverinë e drejtuar nga Ramush Haradinaj për diskriminim të bujqve në raport me ata të komunave të veriut të Kosovës. "Në raportin e punës të Qeverisë Haradinaj, e arritur është paraqitur Udhëzimi Administrativ 09/2018 i ministrit të Bujqësisë.

Ky udhëzim diskriminon bujqit. Derisa bujqve në katër komunat në veri, që janë kryesisht të komunitetit serb, shteti përmes granteve u mbulon 90 për qind të investimit në bujqësi, për bujqit në komunat e tjera në gjithë Kosovën mbulimi i investimeve është vetëm 50 për qind. Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 nuk parasheh ndarje të veçantë të granteve investive



për zona të caktuara. Masat për mbështetje të bujqve aplikohen

në tërë territorin e Kosovës, varësisht prej kulturave bujqësore", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka thënë se Agjencia Kundër Korrupsionit e ka anuluar thirrjen për aplikim për grante të Ministrisë së Bujqësisë të datës 14 prill 2018, me arsyetimin se ajo ka përmbytur diskriminuese. "Por, Ministri i Bujqësisë ka vazhduar nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ

09/2018, ku e ka përligjur diskriminimin dhe më datë 26 maj 2018 e ka rihapur thirrjen për aplikim për bujqit. Anomalia e kësaj shtate është e tillë që thirrja për aplikim për bujqit është bërë më 26 maj 2018, e cila thirrje është bazuar në Udhëzimin Administrativ 09/2018 që ka hyrë në fuqi më 31 maj 2018 (që është 5 ditë më vonë)", ka shkruar Hoti.

Ministri Beqaj: Fuqizimi ekonomik i grave, prioritet yni

PRISHTINË, 2 GUSHT - Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ka mbajtur takim me përfaqësueset e Dhomës Ekonomike të Grave të Kosovës (G7) me qëllim të promovimit të programit për financim të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM). Në këtë takim Beqaj ka ftuar gratë ndërmarrëse të aplikojnë për mbështetje financiare në këtë program, duke theksuar se mbështetja e grave ndërmarrëse të Kosovës është një nga objektivat e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, pasi niveli i ndërmarrjeve të udhëhequra nga gratë

është i ulët. "Gratë ndërmarrëse të Kosovës është dëshmuar se kanë potencial ndërmarrës dhe qëllimi i programit për mbështetje financiare është fuqizimi ekonomik i grave dhe ngritja e potencialit prodhues dhe shërbyes të NVM-ve për rritje të eksportit të produkteve dhe shërbimeve", ka deklaruar Beqaj. Ai ka thënë se gratë ndërmarrëse janë shtyllë e rëndësishme ekonomike në të cilën duhet të investohet më shumë nga shteti. Ai ka siguruar se projektet e grave do të trajtohen me prioritet, pasi objektivi kryesor i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

është përkrahja e grave ndërmarrëse. Ndërsa Arieta Vula-Pozhegu, anëtare e Bordit të G7, ka falënderuar ministrin Beqaj për pjesëmarrje në takim duke shprehur se përkrahja e grave ndërmarrëse nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë nuk do të mungojë. Gratë ndërmarrëse, anëtare të Dhomës Ekonomike të Grave të Kosovës, kanë shfaqur interesimin e tyre për programin e financimit të NVM-ve dhe mundësitë për përfitim të përkrahjes financiare për ndërmarrjet e tyre, me theks në mundësitë e përfitimit nga ndërmarrjet e udhëhequra nga



gratë. Takimi i ministrit Besim Beqaj me G7-shin është mbajtur në kuadër të takimeve që po mbahen me qëllim të promovimit të programit për financim të "star-upeve" dhe NVM-ve. Në fund të takimit ministri Beqaj i ka

ftuar gratë ndërmarrëse, anëtare të G7-shit, që të aplikojnë për përkrahje financiare me projektet e tyre konkrete që ndikojnë në krijimin e vendeve të reja dhe fuqizimin e ekonomisë së Kosovës përmes digjitalizimit.

Punëtorët e KEDS-it paralajmërojnë grevë të përgjithshme



PRISHTINË, 2 GUSHT - Punëtorët e KEDS-it kanë mbajtur një grevë njëorëshe para ndërtesës së kësaj kompanie në Prishtinë duke kërkuar ngritjen e pagave dhe nënshkrim e kontratës kolektive. Ata kanë paralajmëruar grevë të përgjithshme dhe kolaps energjetik në mbarë

vendin nëse kërkesat e tyre nuk plotësohen deri në shtator. Kryetari i Federatës së Sindikatave të Pavarura "Elektrokosova" (FSPE), Ahmet Hyseni, ka paralajmëruar grevë të përgjithshme në rast se nuk plotësohen dy kërkesat e tyre. "Më nuk ka kthim mbrapa. Ne

nuk po kërkojmë diçka që nuk na takon. Neve na takon kontrata kolektive e përgjithshme. Na takon rritja e pagave. Garantoj se në shtator do ta fillojmë grevën e përgjithshme dhe nuk do të ndalemi. Edhe një selam po ua dërgoj këtyre në ndërtesë, sepse është shumë keq të përfi-

tojnë në shpinë të dikujt tjetër. Nuk do të përfitojnë më, për këtë ju garantoj", ka thënë Hyseni. Ndërsa nënkryetari i FSPE-së, Fehmi Pajaziti, ka thënë se ka mjaft hapësirë të realizohen kërkesat e tyre pa ndikuar në tarifën e konsumatorëve.

Thaçi: Partneriteti institucione - biznese, parakusht për suksesin e Kosovës

Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, gjatë vizitës në OEK, ka thënë se vendi ynë ka legjislacionin më të mirë në rajon sa i përket klimës për të ushtruar veprimtari biznese. Në këtë kontekst, Thaçi ka thënë se gjithnjë ka qenë i përkushtuar të ruhet partneriteti në mes të institucioneve shtetërore dhe bizneseve. Ai ka thënë se beson se Kosova do të jetë shtet i mundësive dhe se do të punohet edhe më tepër për sjelljen e investitorëve të huaj në vendin tonë. Ndërsa kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka thënë se liberalizimi i vizave do t'i ndihmojë jashtëzakonisht shumë integritet të ekonomisë sonë në tregjet ndërkombëtare, sidomos në relacion me vendet e Bashkimit Evropian



e tjera institucionale dhe politike ka treguar kujdes të veçantë për bizneset dhe për punën e këtij odë prandaj, sipas tij, ky është vetëm një vazhdim i një komunikimi që ka ekzistuar vazhdimisht. "Një komunikim i cili tash në kapacitetin tjetër, ku roli i presidentit në kuptim të

zhvillimit ekonomik është më i kufizuar, sigurisht se është një garancë e funksionimit të institucioneve dhe si garancë e funksionimit të institucioneve, normalisht e ka rëndësinë e vet për shkak se një funksionim i mirëfilltë i institucioneve, një funksionim demokratik i institucion-

eve, është parakusht edhe për zhvillimin ekonomik", ka thënë Rukiqi. Ai ka theksuar se liberalizimi i vizave do t'i ndihmojë jashtëzakonisht shumë integritet të ekonomisë sonë në tregjet ndërkombëtare, sidomos në relacion me vendet e Bashkimit Evropian.

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 GUSHT - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka vizituar të enjten Odën Ekonomike të Kosovës, ku është pritur në takim nga kryetari i kësaj ode, Berat Rukiqi dhe nga një grup i afaristëve vendorë. Pas takimit, në një konferencë të përbashkët për medie, Thaçi ka thënë se gjithnjë ka qenë i përkushtuar të ruhet partneriteti në mes të institucioneve dhe bizneseve. "Gjithmonë ka qenë në përkushtimet e mia, që të ruhet fokusi te kultivimi i partneritetit në mes të institucioneve të Kosovës dhe biznesit të Kosovës, si kusht i domosdoshëm për sukses të shtetit tonë, për krijimin e kushteve më të mira, më adekuate, më atraktive, për biznes, por edhe për sjelljen e investitorëve të huaj në Kosovë", ka thënë presidenti Thaçi. Ai ka thënë se Kosova ka legjislacionin më të mirë në rajon, i cili, sipas tij, krijon një klimë të përshtatshme për të kryer veprimtari biznese. "Shteti ynë ka një stabilitet të qëndrueshëm, ka një legjislacion bashkëkohor që nuk e kanë vendet e tjera të rajonit. Është një klimë e mirë për bizneset. Do ta ruajmë këtë partneritet të institucioneve për t'i shikuar

mundësitë dhe lehtësuar rrethanat e biznesit në Kosovë. Mendoj se ky koordinim në sektorin privat do të mund ta fuqizojë ekonominë tonë, përpjekjet tona për modernizimin e vendit tonë", ka deklaruar Thaçi. Presidenti Thaçi ka folur edhe për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke theksuar se është një proces që i takon çdo qytetari dhe çdo kategorie të shoqërisë. "Më herët është nënshkruar një marrëveshje në mes të Odës Ekonomike të Republikës së Kosovës dhe Serbisë mbi mundësinë e bashkëpunimit. Do të jetë me rëndësi, që në rast eventuale të arritjes së marrëveshjes historike në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë për paqe, normalizim, pajtim, që nënkupton edhe njohje reciproke mes dy vendeve dhe anëtarësim të Kosovës në të gjitha organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara", ka thënë ai. Thaçi në fund ka thënë se shteti ynë do të jetë shtet i mundësive dhe do të punohet edhe më tepër për sjelljen e investitorëve të huaj në Kosovë. Ndërsa kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se presidenti Thaçi edhe në kapacitetet

Rukiqi: OEK-u i përkushtuar për zgjidhjen e taksës së ujit

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka organizuar një tryezë me prodhuesit e sektorit, në të cilën është diskutuar për taksën e ujit. Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka thënë se së bashku me Klubin e Prodhuesve të Kosovës do t'i japin një zgjidhje faturimit për taksën ujore. Ai ka deklaruar se ka pasur shumë keqkuptime të cilat padrejtësisht janë adresuar ku, sipas tij, po falen borxhet me shifra të caktuara por, në fakt, nuk është falur asgjë. "Kjo duhet të marrë një epilog. Bizneset janë në paqartësi. Edhe Qeveria ka një problem të caktuar që nuk i mbledh këto mjete ose taksa", është shprehur Rukiqi. Sipas tij, ndër pesë çështjet me prioritet të OEK-ut mbetet edhe zgjidhja e problemit të taksës ujore. Ndërsa Bashkim Osmani, kryetar i Shoqatës së Prodhimit të Pijeve Alkoolike dhe Joalkoolike, ka thënë se sfida në raport me taksën e ujit janë duke vazhduar me

vite. "Problemi kryesor me institucionet është taksa e lartë e ujit. Problemi ka qenë me retroaktivitet, ku shumë biznese sot përballen me gjykata. Është e vërtetë se nuk janë paguar taksat, por kjo ka ndodhur për arsye të taksës së lartë dhe as unë nuk e kam paguar. Janë falur borxhet kushtimisht, por jo shuma prej 50 milionë eurosh. Ne jemi të gatshëm ta paguajmë taksën ujore, por duhet të pajisemi me leje ujore", ka thënë Osmani. Ndërsa Vëllaznim Osmani nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës ka thënë se shumë herë kanë qenë afër zgjidhjes së problemit të taksës ujore, por ndryshimet e shpeshta të qeverive e kanë bërë të pamundur. "Me anë të një udhëzimi administrativ në vitin 2016 një prej kërkesave ka qenë të fillojë faturimi, ndërsa sot jemi në vitin 2018, mirëpo askush nuk e di saktë sa është borxhi dhe ende është duke vazhduar ky

problem", është shprehur Osmani. Krejt në fund, prodhuesi Visar Kelmendi ka thënë se që 13 vjet është duke vazhduar problemi i faturimit të resurseve të ujit dhe legalizimit të këtij sektori. "Ne kemi pranuar të legalizohemi, por jo në formën si ka dëshiruar Qeveria. Ky borxh, sipas nesh, nuk ekziston", ka thënë ai. Kelmendi ka thënë se neni 12 i një udhëzimi administrativ është famëkeq në raport me borxhet. "Andaj kërkojmë me ngulm që të na i dërgojnë faturat dhe kërkojmë legalizim. Kryeministri Ramush Haradinaj mori një vendim, por presionin politik që e pati, ai vendim nuk gjeti zbatim, sepse e quajtën kryeministrin hajn. Po ashtu, edhe neve na quajtën hajna dhe të papërgjegjshëm. Më së paku është faj tek ne, problemi është në Qeveri", ka theksuar Kelmendi.

OEAK-u: Projektligji për pagat rrezikon qëndrueshmërinë buxhetore

PRISHTINË, 2 GUSHT - Ruajtja e stabilitetit makroekonomik përmes një qasje të kujdesshme në shpenzimin e parasë publike ka rëndësi të madhe në zhvillimin ekonomik afatgjatë të Kosovës. Kështu ka vlerësuar Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) nëpërmjet një komunikate për medie. Në këtë aspekt, kjo odë ka theksuar se institucionet e vendit kanë për obligim të sigurojnë që ky stabilitet nuk rrezikohet në asnjë rrethanë. "Krahas qëndrimeve të shprehura së fundmi mbi shpenzimin e

pakontrolluar të parasë publike, Oda Amerikane shpreh shqetësimet edhe mbi Projektligjin për pagat, duke vlerësuar se i njëjti rrezikon qëndrueshmërinë buxhetore si dhe rrit edhe më shumë hendekun e pagesave ndërmjet sektorit publik dhe atij privat", është thënë në komunikatën e OEAK. Sipas kësaj ode, miratimi i këtij projektligji në formën aktuale do të kishte implikime të konsiderueshme dhe do ta rriste deficitin buxhetor në vend. "Rritja e pjesëmarrjes së pagave në buxhetin e vendit do të ndodhte në kur-



riz të rënies së investimeve kapitale që janë të një rëndësie shumë të madhe në aspekt të fuqizimit të sektorit privat dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik. Për më tepër, rritja e deficitit pa dyshim se do të çonte në rritjen e barrës tatiimore për bizneset ekzistuese në vend, duke marrë parasysh nevojën për mbledhjen e më

shumë të hyrave. Krahas ndikimit buxhetor, Projektligji mbi pagat do të ndikonte negativisht edhe mbi tregun e punës në vend. Sektorin privat nuk mund ta ndjekë ritmin e institucioneve në rritjen e pagave, meqë pagat në këtë sektor përcaktohen nga forcat e tregut dhe produktiviteti i fuqisë punëtore. Rritja e hendekut të pagesave do ta nxiste edhe më shumë fuqinë punëtore që ta konsiderojë sektorin publik si punëdhënësin e preferuar", është thënë në këtë komunikatë. Oda Ekonomike Amerikane në

Kosovë (OEAK) i ka kërkuar Qeverisë së Kosovës të tregohet e kujdesshme me nivelet e propozuara të pagave në Projektligjin mbi pagat, gjithnjë duke u bazuar në rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar. "Përderisa reformimi i administratës publike është një proces tejet i rëndësishëm dhe i pashmangshëm, ky reformim duhet të udhëhiqet nga nevoja për ta rritur produktivitetin e punëtorëve në sektor dhe ofrimin e shërbimeve më të mira publike", është thënë në komunikatën e OEAK-ut.

Aksident në Suharekë, dy të vdekur

SUHAREKË, 2 GUSHT - Dy persona, një femër dhe një mashkull, kanë ndërruar jetë në një aksident trafiku që ka ndodhur në fshatin Dubravë të Suharekës. Sipas komandantit të trafikut për rajonin e Suharekës, Sabit Kabashi, në

këtë aksident janë lënduar edhe dy fëmijët të cilët janë jashtë rrezikut për jetë. "Rreth orës 13:50, në dalje të fshatit Dubravë, në drejtim të fshatit Mushtisht, ka ndodhur një aksident trafiku ndërmjet dy veturave, njëra me tabela të

Kosovës, tjetra me tabela të Francës. Dy persona kanë ndërruar jetë ka konstatuar ekipi mjekësor në vendin e ngjarjes", ka thënë Kabashi. Sipas tij, viktimat janë njëri burrë, tjetra grua, të moshës 37-38 vjeç.



Përkujtohet dëshmori Isuf Ahmeti

GJAKOVË, 2 GUSHT (ER) - Ish-mësuesi, pedagogu dhe ushtari i UÇK-së, Isuf Ahmeti nga fshati Stubëll i Gjakovës, është përkujtuar të enjten me rastin e 20-vjetorit të rënies. Ahmeti qysh në ditët e para të luftës së UÇK-së ishte angazhuar në zonën e

Dukagjinit dhe ishte ndër ushtarët më të respektuar të fshatit. Ai ka rënë heroikisht më 2 gusht të vitit 1998 gjatë një ofensive të ndërmarrë nga forcat policore e ushtarake serbe në fshatrat e Rekës së Keqe. Trupi i tij prehet në varrezat e fshatit Stubëll.

Hapet panairi i prodhimeve bujqësore në Ferizaj

FERIZAJ, 2 GUSHT (ER) - Organizuar nga Iniciativa për Komunitetin e Kosovës (IKC) në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë të Komunës së Ferizajt, këtë të enjte është bërë hapja e panairit me prodhime bujqësore. Nga afër fermerët që po marrin pjesë në këtë panair i ka vizituar edhe kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, së bashku me nënkryetarin Naim Feratin,

si dhe drejtorët e drejtorive komunale. Me këtë rast, Agim Aliu ka theksuar se ky panair është mundësi e mirë për fermerët që t'i promovojnë produktet vendore. "Ky panair më bëri të ndihem jashtëzakonisht mirë e falënderues për punën dhe angazhimin që bëjnë këta fermerë të palodhur, këta fermerë që i kam çmuar dhe do t'i çmoj gjithmonë, sepse janë

pjesa që jetojnë tamam me djersën e tyre", ka thënë Aliu. Ndërsa Ekrem Bajrami, drejtor ekzekutiv i Organizatës Iniciativa për Komunitetin e Kosovës (IKC), ka thënë se në këtë panair janë duke marrë pjesë mbi 50 fermerë me produktet e tyre. Ky panair do të jetë treditore, ndërsa po organizohet në kuadër të "Ditëve të Diasporës Ferizaj 2018".



Pajtohen për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Gjilanit dhe Gostivarit



Gjilan 2 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim punë kryetarin e Komunës së Gostivarit, Arben Taravari, me të cilin kanë biseduar për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit në nivel komunal përmes programeve e projekteve të përbashkëta ndërkomunale në të mirë të qytetarëve të dy komunave. Haziri ka thënë se Gjilani dhe

Gostivari kanë shumëçka të përbashkët, duke përfshirë kulturën dhe komunikimin. "Dëshiroj që bashkëpunimi Gjilan - Gostivar të thellohet edhe më shumë dhe, pse jo, të kemi bashkëpunim të pushtetit lokal edhe jashtë regjionit tonë, duke e ndihmuar njëri-tjetrin për përfaqësim sa më të mirë", ka thënë Haziri. Ndërsa kryetari i Gostivarit, Arben Taravari, ka vlerësuar lart

punën e kryetarit Haziri si kryetar i Gjilanit. "Ne si komunë, së bashku me Gjilanin, mund ta bëjmë implementimin e projekteve të përbashkëta ndërkomunale. Raportet tona do të vazhdojnë të thellohen dhe të jenë edhe më me intensitet, përmes ideve, projekteve dhe bashkëpunimit ndërkomunal e ndërshtetëror", ka thënë Taravari.

Asfaltohet rruga në Lubizhdë të Malishevës

MALISHEVË, 2 GUSHT (ER) - Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore në vendbanimet e Komunës së Malishevës, të enjten ka filluar asfaltimi i një rruge në fshatin Lubizhdë, e cila e lidhë pjesën e fshatit që gjendet në anën tjetër të lumit Mirusha. Me këtë rast,

nënkryetari i Malishevës, Hajdin Berisha, ka vizituar fshatin Lubizhdë për të parë nga afër asfaltimin e kësaj rruge. "Rregullimi i infrastrukturës në përgjithësi, në veçanti i infrastrukturës rrugore, në territorin e Komunës së Malishevës është duke shkuar shumë mirë, sepse

të gjitha rrugët kryesore janë të asfaltuara dhe tani neve na mbetet t'i rregullojmë edhe rrugët brenda lagjeve, apo lidhjet mes lagjeve, siç është kjo rrugë", ka thënë Berisha. Kjo rrugë është e gjatë 650 metra dhe është financuar nga buxheti i Komunës së Malishevës.



Kryeministri Haradinaj përkujton komandant 'Rokin'

DARDANË, 2 GUSHT - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, me rastin e 17-vjetorit të vdekjes së Rahim Beqirit, i njohur si komandant "Roki", të enjten ka bërë homazhe te lapidari i tij në fshatin Kopërnice të Komunës së Dardanës. Pas homazheve, kryeministri Haradinaj me shumë bashkëluftëtarë dhe bashkëpunëtorë të tjerë, në

nderim të jetës dhe veprës së komandant "Roki", kanë marrë pjesë në ecjen tradicionale "Rahim Beqiri - komandant Roki", që përshkon rrugën nga Kulla e Kadri Zekës në Poliçkë-Kikë e deri në Gmicë. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka vlerësuar kontributin e Rahim Beqirit dhe të gjithë dëshmorëve të UÇK-së për lirinë e Kosovës.



Ismaili: Shëndeti i nënave dhe fëmijëve, prioritet i kujdesit shëndetësor

PRISHTINË, 2 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se gjatë këtij viti janë realizuar mijëra vizita për nëna dhe fëmijë në shtëpi. Ai ka treguar se ky program tashmë ka arritur të shtrihet në 14 komuna të shtetit të Kosovës. Ismaili ka premtuar se shëndeti dhe mirëqenia e nënave dhe fëmijëve do të jetë në qendër të kujdesit shëndetësor. "Prindërit nuk kanë vendosur ende për emrin e kësaj vogëlushjeje të mrekullueshme, por ekipi ynë, motra Nexhipe dhe motra

Bajreta, tashmë e kanë bërë vizitën e parë në familjen Halimi në Dragash, vetëm dy ditë pas lindjes, për ta monitoruar gjendjen e nënës dhe të foshnjës. Gjatë këtij viti kemi realizuar mijëra vizita për nëna dhe fëmijë në shtëpi dhe e kemi shtrirë këtë program në 14 komuna. Shëndeti dhe mirëqenia e nënave dhe fëmijëve do të jetë në qendër të kujdesit tonë shëndetësor, andaj do t'i shtrijmë ato në të gjithë Kosovën", ka shkruar Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook".

Fillon projekti për rregullimin e ndriçimit publik në Drenas

DRENAS, 2 GUSHT (ER) - Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, ka filluar zbatimin e projektit "Rregullimi i ndriçimit publik me masa eficiente". Në këtë projekt parashihet të bëhet rregullimi i ndriçimit publik me masa eficiente, me trupa ndriçues dhe llamba "Led" në rrugët e qytetit të Drenasit, përkatësisht në rrugët: "Shaban Shala" dhe "Antigona Fazliu", duke përfshirë rrugën "Sokol Elshani" në

Shtrubullova dhe atë "Ali Lladrovci". Po në këtë projekt përfshihet edhe ndriçimi i rrugëve "Fadil Krasniqi", "Emin Krasniqi", "Ali Gashi", "Paria e Drenicës", "Rasim Sopi" dhe "Nazmi Gashi" në Komoran. Punimet në këtë projekt janë duke u implementuar sipas planit dinamik dhe do të jenë në mbikëqyrje të menaxherit të organit mbikëqyrës. Ky projekt është bashkëfinancim në mes të Komunës së Drenasit dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).



Policisë i ndalohet shkuarja në pushime

PRISHTINË, 2 GUSHT - Me një urdhër operativ Policia e Kosovës ua ka ndërprerë shkuarjen në pushime pjesëtarëve të uniformuar të saj. "Kallxo.com" ka sig-

uruar përmbajtjen e një letre të cilën drejtori i Operativës, Rashit Qalaj, e ka dërguar te vartësit e tij. "Për shkak të angazhimeve operacionale ndërpritet mirati-

mi i pushimeve për stafin e uniformuar deri në një vendim tjetër", është thënë në e-mailin e dërguar nga drejtori i Operativës, Rashit Qalaj. Ndërsa

në përgjigjen e Policisë së Kosovës nuk është shkruar arsyeja e një vendimi të tillë. "Policia e Kosovës, sipas planifikimeve operacionale,

ndërmerr edhe veprime të planifikimit të burimeve njerëzore për realizimin e detyrave zyrtare në mënyrë më efektive", është thënë në përgjigjen e Policisë.

Trumpi, falënderim të veçantë për Kim Jongun

WASHINGTON, 2 GUSHT - Presidenti amerikan Donald Trump falënderoi të enjten nëpërmjet një postimi në "Twitter" udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jongun, një ditë pas mbërritjes në ShBA të eshtrave që mendohet se mund të jenë të ushtarëve amerikanë të vrarë gjatë luftës

koreane. Postimin e tij drejtuar udhëheqësit të Phenianit, Trumpi e përfundonte duke thënë se "mezi priste të shihej me të së shpejti", ndoshta duke shprehur interes për një tjetër takim. Në Singapor gjatë takimit të tyre historik, udhëheqësi i Phenianit

u pajtua "ta realizonte çarëmatimin bërthamor të Gadishullit Korean", por dokumenti i nënshkruar nga dy udhëheqësit nuk përmbante hollësi se si dhe kur do të ndodhte kjo.

Javën e kaluar sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha se Koreja e Veriut po prodhon ende

lëndë djegëse për armë bërthamore, pavarësisht prej premtimeve për të hequr dorë nga programi i saj bërthamor.

Edhe gazeta "Washington Post" raportonte se agjencitë amerikane të zbulimit kanë të dhëna, nëpërmjet fotografish satelitore, se Koreja e Veriut po



ndërton raketa të reja në një impiant të madh kërkimor në Sanumdong.

Në Kongres, kambana alarmi për ndërhyrjen ruse

Ligjvënësit amerikanë u paralajmëruan se përpjekjet ruse për të krijuar konfuzion dhe polarizim në mes të amerikanëve janë më agresive dhe të dëmshme se kurrë më parë. Kanë mbetur më pas se 100 ditë deri në zgjedhjet e Kongresit dhe ekspertët e kibernetikës dhe medias sociale po i bien kambanës së alarmit



forumi modern publik. Dhe po përdoret për të na përçarë", tha senatori republikan, Richard Burr.

Ligjvënësit në seancën e komisionit shprehën zhgënjim. "Ne vendosëm sanksione ndaj Rusisë. Duket se ato nuk kanë pasur efekt kur bëhet fjalë për këtë lloj aktiviteti", tha senatorja republikane, Susan Collins.

Komisioni njoftoi se ekzekutivët

e medias sociale do të dëshmojnë muajin e ardhshëm për hapat që duhen ndërmarrë për t'u kundërpërgjigjur ndaj fushatave për ndikim të huaj.

"Facebook', 'Instagram', 'Twitter', 'Google' dhe 'YouTube' kanë ende shumë punë për të bërë", tha senatori Warner.

Por, a mjafton kjo?

"Platformat e medias sociale nuk mund dhe nuk duhet të jenë

mbrojtëset e vetme të

demokracisë dhe diskutimit

publik. Prandaj ne sugjerojmë

veprime të menjëhershme për t'i

identifikuar dhe eliminuar

fushatat me ndikim negativ dhe

ndërgjegjësuar publikun në

përgatitje për zgjedhjet e vitit

2018", thotë Renee DiResta,

drejtoreshë kërkimesh në

organizatën "New Knowledge".

Pas më shumë se një viti

hetimesh për Rusinë, ligjvënësit

thonë se e kanë të qartë synimin

e Moskës. "Është luftë informa-

cioni e pastër, një tjetër lloj lufte

për t'i dobësuar kundërshtarët

dhe nga ky këndvështrim i sheh

Vladimir Putini Shtetet e

Bashkuara", thotë senatori

republikan, Marco Rubio. Ai

është bashkautor i një projektligji

për sanksione të mëtejshme

kundër Rusisë, nëse zbulimi

amerikan arrin në përfundimin

se Moska po ndërhyr në zgjedhjet

e nëntorit për Kongresin.

WASHINGTON, 2 GUSHT - Një ditë pasi rrjeti social "Facebook" mbylli 32 llogari mediesh të rreme që përhapnin mesazhe përçarëse politike, ligjvënësit amerikanë u paralajmëruan se përpjekjet ruse për të krijuar konfuzion dhe polarizim mes amerikanëve janë më agresive dhe të dëmshme se kurrë më parë. Si ligjvënësit republikanë, edhe ata demokratë janë të shqetësuar. Kanë mbetur më pak se 100 ditë deri në zgjedhjet e Kongresit dhe ekspertët e kibernetikës dhe të medias sociale po i bien kambanës së alarmit.

"Manipulimi rus nuk u ndal në vitin 2016. Pas ditës së zgjedhjeve, Qeveria ruse i shtoi përpjekjet", thotë John Kelly, drejtor ekzekutiv i kompanisë "Graphica".

Lajmi për "Facebook"-un konfirmon se problemi vazhdon. "Operativët e mbështetur nga rusët vazhdojnë të depërtojnë dhe ta manipulojnë medien sociale për ta marrë nën kontroll debatin kombëtar dhe për t'i vënë amerikanët kundër njëri-tjetrit", tha senatori demokrat i Komisionit të Zbulimit, Mark Warner. "Media sociale është

Problemet ekonomike nxisin protesta në Iran



TEHERAN, 2 GUSHT - Qindra protestues kanë dalë nëpër rrugë, në disa qytete iraniane, për ta shprehur pakënaqësinë e tyre lidhur me vështirësitë ekonomike që po përballen vendi. Irani po përballen me inflacion të lartë dhe vështirësi në rritje ekonomike, që është shkaktuar pjesërisht nga rënia dramatike e vlerës së valutës kombëtare rial. Për këto arsye qytetarët kanë protestuar në mbarë vendin ditët e fundit.

Qeveria iraniane, përmes një gazete qeveritare, njoftoi se

"tubimet e shpërndara dhe pa leje" u mbajtën në qytetin Mashhad, Karaj, Shiraz dhe në një shesh në kryeqytetin Teheran. Disa prej protestave janë ndërprerë "nga forcat policore", ka njoftuar gazeta.

Në Shiraz, që gjendet në provincën Fars, agjencia shtetërore e lajmeve IRNA ka raportuar për përlëshje në mes të protestuesve dhe policisë. Megjithatë, nuk ka raportime për të lënduar apo të arrestuar.

Valuta rial ka humbur pothuajse gjysmën e vlerës ndaj dollarit

amerikan që prej muajit prill. Zhvlerësimi i valutës është nxitur edhe më shumë, pasi ShBA-ja u tërhoq nga marrëveshja bërthamore e vitit 2015 dhe rivendosi sanksione ekonomike ndaj Teheranit.

Të përballur me pakënaqësinë e publikut, ligjvënësit iranianë, më 1 gusht, i dhanë presidentit Hassan Rohani një muaj afat që të paraqitet para Parlamentit dhe të përgjigjet në pyetjet që kanë të bëjnë me dobësimin e rritjes ekonomike, rritjen e papunësisë dhe zhvlerësimin të rialit.

Thirrje për përmbajtje nga dhuna në Zimbabve

HARARE, 2 GUSHT - Komuniteti ndërkombëtar bëri thirrje për përmbajtje në Zimbabve, një ditë pasi protestat në kryeqytetin Harare midis forcave të sigurisë dhe mbështetësve të opozitës lanë të vrarë tre persona. Protestat nisën pasi Komisioni

Zgjedhor i Zimbabvesë shpalli fituese të shumicës në parlament partinë në pushtet Zanu-PF. Opozita tha se Zanu-PF ka manipuluar me procesin zgjedhor - i pari që është mbajtur pa përfshirjen e udhëheqësit shumëvjeçar, Robert Mugabe.

Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, u kërkoi politikanëve të Zimbabvesë të ushtrojnë përmbajtje. Ngjashëm kërkoi edhe Ambasada amerikane në Harare, duke thënë se vendi ka pasur një "mundësi historike" për të

ardhme më të ndritshme. Ministrja e Zyrës së Jashtme britanike, Harriett Baldwin, tha se është "thellësisht e shqetësuar" nga dhuna. Ministri i Punëve të Brendshme i Zimbabvesë, Obert Mpofu, tha se Qeveria nuk do të tolerojë protesta.



E rrallë

Biçikleta që konkurron me Ferrarin

Kompania "Goldgenie" nga Londra ka prodhuar një biçikletë garash për meshkuj, të mbuluar me ar 24 karatë, duke konkurruar me Ferrarin. Çmimi i saj është 250 000 dollarë, çfarë e bën atë më të shtrenjtën në botë. Çdo pjesë e biçikletës, duke nisur që nga zinxhiri, dhëmbëzat e rrotave janë prej ari. Për ta kombinuar ngjyrën "gold", prodhuesit e kanë kombinuar të zeza pjesën e gomave. Tek shala



janë përdorur lëkurat ekzotike, të përbëra me një shumëllojshmëri gurësh të çmuar.

FOTO E DITES



Kuajt poni duke notuar në Kanalin Assateague në Virxhini të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). /AFP/

E jashtëzakonshme

Zbulimi i pabesueshëm në piramidat e Egjiptit

Zbulohet sekretet e energjisë mistike të piramidave të Egjiptit. Përtej legjendave dhe hamendësimeve për të gjithë këta shekuj, piramida e Keopsit është studiuar me metodat fizike dhe ka rezultuar se ajo arrin ta koncentrojë energjinë elektrike dhe magnetike, si në dhoma ashtu edhe nën bazën e saj, në mënyrë të njëtrajtshme. Kërkuesit e ITMO University kanë vërtetuar shpërndarjen e fushave



magnetike në brendësi të piramidës, duke studiuar edhe ndërveprimin në mes të valëve të gjatësive të ndryshme prej 200 dhe 600 m. Megjithatë, duke qenë se në brendësi të piramidës së Gizës nuk është zbuluar ende plotësisht çdo gjë, pasi mendohet se mund të ketë ende dhoma të fshehta, studiuesit kanë vijuar me hipoteza.

BARSOLETA E DITËS



Gruaja: A je normal ti, krejt rrogën po e harxhon tuj pi raki?
Burri: Edhe ti krejt paret në kozmetikë po i lë.
Gruaja: Unë po blej kozmetikë për t'u dukur ty e bukur.
Burri: Edhe unë po pi raki që me m'u dukë ti e bukur.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"INCREDIBLES 2" 3D

I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

Rolet: Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

Regjia: Brad Bird




Në ora 18:20

"FUTURE WORLD" 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

Regjia: James Franco



Në ora 20:00

"ANT-MAN AND THE WASP" 3D

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

Rolet: Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

Regjia: Peyton Reed




Në ora 22:00

"LOVING PABLO" (R)

Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

Rolet: Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

Regjia: Fernando León de Aranoa



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Kjo ditë do t'ju gjejë më romantik dhe ëndërrimtar. Jeta në çift do të jetë e shkëlqyer. Edhe pse në punë keni disa luhajtje, ato nuk do të jenë problematike.



DEMI

Po jetoni një fazë qetësie dhe harmonie, duke e shijuar jetën në maksimum. Megjithatë, duhet të jeni më të përqendruar në punë. Bëni kujdes në dashuri.



BINJAKËT

Dita do të jetë interesante për të nisur një projekt të ri. Do të hapet një fazë produktiviteti dhe rritje personale e profesionale.



GAFORRJA

Mundohuni t'i analizoni në detaje të gjitha propozimet e bëra së fundmi. Nëse ndiheni të pasigurt dhe keni dyshime atëherë është mirë të flisni hapur me miqtë.



LUANI

Jeni shumë të lodhur, kështu që është normale ta ndjeni nevojën të shkëputeni nga rutina e përditshme për një pushim të paharruar. Do të keni rezultate të mira në punë.



VI RGJËR ESHA

Disa risi do t'ju lëkundin, por tashmë duhet ta përpunoni strategjinë alternative për të çuar deri në fund të gjitha projektet tuaja. Do të keni disa probleme me partnerin.



PESHORJA

Bëni mirë të mos i harroni disa zhgënjime në dashuri ose në familje. Përfitoni nga mbrëmja, për të bërë një ballafaqim me ata që ju paragjykojnë.



AKREPI

Mos e kaloni këtë ditë duke u marrë me gjëra të kota dhe aspak produktive. Bëni mirë të përballeni me disa prova stimuluese dhe inkurajuese për karrierën tuaj.



SHIGJETARI

Do të jetë një ditë shumë intensive. Duhet të jeni më të kujdesshëm në raportet me rrethin. Kjo ditë parashikon një miqësi të transformuar në diçka më shumë.



BRICJAPI

Dita do të jetë e mbarë nga pikëpamja profesionale, ku do të jeni në gjendje të mbyllni çështje interesante, të cilat do t'ju lejojnë të keni përfitime të shumta.



UJORI

Do të ketë disa tensione të cilat duhet t'i zgjidhni. Në momentet nervoze prireni të jeni agresiv. Duhet të jeni më të hapur për dialog.




PESHQIT

Për të arritur një objektiv që i keni vendosur vetes, duhet të jeni të gatshëm të punoni shumë dhe të bëni ndonjë sakrificë nga pikëpamja ekonomike.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

READING - DERBY

2

HANSA ROSTOCK - BRAUNSCHWEIG

1

LE HAVRE - GRENOBLE

1

Gashi: Kosova të prezantohet me dinjitet në garat ndërkombëtare

Kampionët e basketbollit U18 për Divizionin C janë pritur nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, i cili, pasi i ka uruar për suksesin e arritur, ka kërkuar që në garat ndërkombëtare të gjithë sportistët ta japin maksimumin për prezantim të dinjitetshëm

EPOKA E RE Liridon ZEQRIRI

PRISHTINË, 2 GUSHT - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka kërkuar nga basketbollistët që në garat ndërkombëtare ta japin maksimumin për prezantimin e sportit të Kosovës në mënyrë sa më të mirë. Numri një i sportit në Kosovë këto komente i ka bërë pas takimit që pati të enjten me përfaqësuesen e Kosovës në Basketboll (U18, meshkujt), të cilët ditë më parë arritën një sukses të madh duke u shpallur kampionë në Kampionatin Evropian, Divizioni C, i cili u mbajt në Prishtinë.

Ministri i ka uruar basketbollistët dhe drejtuesit e klubit për suksesin e arritur. Ai vlerësoi se me angazhim dhe vullnet mund të arrihet deri te sukcesi siç edhe kanë treguar basketbollistët në rend të parë, por edhe stafi mbështetës i tyre, trajnerët e të gjithë personat e tjerë të angazhuar. Gjithashtu, ministri i ka përgëzuar drejtuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës edhe për organizimin e kampionatit në fjalë. "Ministri Gashi ka kërkuar nga basketbol-



listët dhe përfaqësuesit e klubit që në përfaqësimet ndërkombëtare ta japin maksimumin dhe ta prezantojnë Kosovën sa më me dinjitet. Ai u premtoi mbështetjen e plotë të MKRS-së edhe në të ardhmen", thuhet në njoftimin e MKRS-së.

Ndërsa basketbollistët dhe drejtuesit e Federatës e falënderuan ministrin Gashi për mikpritjen, urimin dhe gatishmërinë e treguar për ta mbështetur basketbollin. Ata premtojnë se në

garat ndërkombëtare që do të marrin pjesë do të përfaqësojnë në mënyrë sa më të mirë të mundshme jo vetëm klubin dhe qytetin e tyre, por edhe Kosovën.

U18-ja e femrave në Austri për Kampionatin Evropian

Përfaqësuesja U18 e Kosovës në konkurrencën e femrave ka udhëtuar të enjten për në Austri,

ku do të marrë pjesë në FIBA U18 Kampionatin Evropian, Divizioni B, që do të organizohet prej 3 deri më 12 gusht në Furstenfeld, Gussing dhe Oberwart. Kosova U18 është në Grupin D së bashku me Norvegjinë, Ukrainën, Bjellorusinë, Sllovakinë dhe Luksemburgun. Duhet theksuar se kjo është hera e parë që Kosova U18-Femrat do të bëjë gara në Divizionin B, pasi në dy vjetët e para që nga pranimi i FBK-së në FIBA ka barë gara në Divizionin C.

FFK-ja vendos sistemin digjital në Superligë

PRISHTINË, 2 GUSHT - Federata e Futbollit të Kosovës ka vendosur që në sezonin e ri futbollistik 2018/2019 ta zbatojë sistemin digjital të garave. Ky projekt fillimisht do të nisë vetëm me Superligë, derisa nga edicioni i ardhshëm do të nisë edhe në kategoritë e tjera. FFK-ja me këtë rast ka organizuar një seminar me administratorët e 12 klubeve të Superligës, me qëllim të njoftimit dhe testimi të këtij sistemi. Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka treguar për rëndësinë që ka ky projekt për FFK-në, por edhe për vetë klubet, në mënyrë që edhe futbollit i Kosovës të jetë në hap me Evropën. "Pikërisht nga pjesa administrative fillon edhe ngritja e cilësisë së ligës, prandaj sistemi digjital është shumë



i rëndësishëm në këtë aspekt dhe do t'u shërbejë edhe klubeve. Ky ka qenë një projekt goxha i kushtueshëm, por edhe i domosdoshëm, prandaj ne

kemi vendosur ta zbatojmë në praktikë", ka thënë Ademi. Ndërsa për mënyrën e punës në këtë sistem administratorët e klubeve i kanë njoftuar

administratori Adem Çollakaj dhe shefi i IT-së, Dardan Sadiku. Ky sistem është vazhdimësi dhe i ndërlidhur me sistemin FIFA Connect.

SHKURT

Ferizaj transferon edhe Genc Hamitin

Skuadra e rikthyer në Ferizaj në Superligë, Ferizaj, pas angazhimit të Afrim Tovërlanit në krye të shtabit teknik, ka transferuar Florim Bërbatovcin, Fuad Karabegun dhe Granit Jasharin, kurse transferimi i këtij klubi është Genc Hamiti. "Top sulmuesi drenicas, Genc Hamiti, edhe zyrtarisht është pjesë e klubit tonë. Ai që në ndeshjen e parë për klubin tonë arriti të shënojë dy gola ndaj Vllaznisë së Pozhoranit në ndeshjen miqësore. Gjithashtu, ju njoftojmë se së shpejti priten të prezantohet një portier nga Maqedonia dhe dy futbollistë nga Shqipëria", thuhet në njoftimin e KF Ferizaj.

Hannoveri kërkon Mavrajn

Mërgim Mavraj është në kërkim të një klubi të ri pas ndarjes me Hamburgun. Në skenë për mbrojtësin shqiptar ka dalë edhe Hannover 96. Shanset janë të mëdha që mbrojtësi i Kombëtares të transferohet te skuadra e Bundesligës, pasi ai mund të lëvizë me kosto 0. Përvoja e tij në kampionatin gjerman pritet ta ndihmojë skuadrën.

Januzaj, pasardhës i Marhezit

Riyad Mahrez i është bashkuar kampionit të Premierë Ligës, Manchester City. Ndërsa Leicester City e ka shënjestruar Adnan Januzaj si pasardhës të Mahrezit. 23-vjeçari Januzaj ishte transferuar te Real Sociedad verën e kaluar nga Unitedi për tetë milionë funte, pasi kaloi disa muaj huazim te Borussia Dortmundi dhe Sunderlandi.

Collina largohet nga UEFA

ROMË, 2 GUSHT - Një rotacion tërësisht italian në majat e arbitrazhit evropian. Pierluigi Collina jep dorëheqje nga posti i kryedisenjatorit të gjyqtarëve të UEFA-s, e në vend të tij do të nominohet Roberto Rosetti,

përgjegjësi aktual italian i videoarbitrimin, VAR. Largimi i Collinës, ish-gjyqtari më i vlerësuar italian dhe jo vetëm, ndodh për motive personale. Collina u emërua në vitin 2010 në postin e kryedisenjatorit të arbitrave për

kompeticionet e zhvilluara në kontinentin e vjetër, pas telefonatës që i bëri ish-presidenti i atëhershëm Michel Platini. Gjithsesi, shtatë herë fituesi i çmimit "Gjyqtari më i mirë i vitit" do ta mbajë rolin e presidentit të Komisionit të

Gjyqtarëve në FIFA, post që e ka marrë nga janari i vitit 2017. "Ishte një privilegj për mua të punoja si kreu i gjyqtarëve të UEFA-s në këta tetë vjet. Jam krenar për rezultatet e arritura së bashku me kolegët e mi", ka thënë Collina.



Duka dhe Sejдини mbështesin Ademin



PRISHTINË, 2 GUSHT - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, sot (e enjte) priti në një takim presidentin e Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka dhe ushtruesin e kryetarit të Federatës së Futbollit të Maqedonisë, Muhamet Sejđinin. "Jemi këtu për ta uruar Ademin për postin e kryetarit dhe ta rikonfirmojmë mbështetjen për të dhe FFK-në. Do të doja që sot ta takoja mikun tim Fadil Vokri,

por ai tash nuk është më dhe jeta duhet të vazhdojë. Ademin do ta mbështesim në të gjitha fushat, mbase edhe më tepër sepse në këto çaste ka nevojë më shumë. Do të punojmë për zhvillimin e futbollit në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni dhe ne mund ta bëjmë gjëra të mira në këtë drejtim", ka thënë Armand Duka, kryetar i FShF-së. Ashtu sikurse Duka, edhe Sejđini ka ofruar mbështetje për kryetarin e ri të FFK-së, Agim

Ademi. "Është e vështirë të vish në Kosovë e të mos e takosh legjendën e futbollit, Fadil Vokri, por këto i ka jeta dhe ne do të ecim tutje. Edhe unë e siguroj Ademin se do ta vazhdojmë bashkëpunimin gjithnjë në të mirë të futbollit të tri vendeve", ka deklaruar ai. Ndërsa kryetari Ademi i ka falënderuar mysafirët për mbështetjen që i kanë dhënë dhe ka premtuar bashkëpunim edhe në të ardhmen.

LeBron: Do të jetë një sezon argëtues



LOS ANGELES, 2 GUSHT - LeBron Jamesi beson se kalimi i tij te Lakersi është një gjë e mirë për basketbollin dhe NBA-në, pasi do të luajë tek një prej skuadrave legjendare të këtij sporti, me shpresën që kalifornianët të duelojnë sa më shpejt për titullin. "Ideja për të ndihmuar një ekip të tillë është një stimul i madh për mua, që më shtyu ta bëj këtë hap. Lakersi nuk luan në "play-off" prej disa sezonesh,

por po flasim për një nga ekipet më të mëdha dhe të rëndësishme në NBA. Të jesh pjesë e këtij ekipi ka qenë vendimi më i mirë që kam marrë për të ardhmen time dhe të familjes", ka thënë LeBron. Duke folur për skuadrën e re, stafin e lojtarët, Jamesi mendon se së bashku do të krijojnë një miks fantastik, ku përvoja e tij do të ndërthuret me energjinë e të rinjve. "Drejtuesit e Lakersit vendosën të afrojnë

lojtarë që e duan basketbollin, lojtarë si Rondo, Stephenson, Beasley e McGee, që jetojnë për basketbollin dhe që gjërat e tjera i kanë në plan të dytë. Ndërkohë që janë mjaft të rinj që duan të shpërthejnë dhe do t'i ndihmoj. Ky ka për të qenë një sezon argëtues për ne dhe jo një vit ku do të rindërtojmë nga e para ekipin. Kemi shansin të realizojmë diçka të jashtëzakonshme", ka deklaruar LeBron.

SHKURT

Bonucci në Juve, Higuaini dhe Caldara në Milan

Transferime të papritura kanë ndodhur në Serinë A. Dy skuadrat gjigante, Juventus dhe Milan, kanë shkëmbyer futbollistë ndërmjet vete, ku spikat rikthimi i mbrojtësit Leonardo Bonucci në Juventus. Ndërsa Gonzalo Higuain dhe mbrojtësi Caldara e kanë përforcuar skuadrën e Milanit.

Ajdareviç, afër largimit nga AEK-u

Astrit Ajdareviç është pranë largimit nga AEK-u i Athinës. Sipas asaj që bën me dije "FootballDirect", tashmë kanë filluar kontaktet midis klubit grek të AEK-ut dhe IFK Goteborgut. Klubi suedez ka zhvilluar edhe turneun parasezonal, por ka pasur edhe disa largime të rëndësishme nga klubi. Tashmë prej kohësh drejtori sportiv Mats Gren ka shpjeguar se është duke kërkuar për një mesfushor të majtë dhe qendror dhe një sulmues. Në fund të javës mendohet se klubi suedez do të vijë me një ofertë konkrete për lojtarin shqiptar.

Martiali, Mourinhos: Familja mbi të gjitha

Manchester Unitedi e ka dënuar futbollistin Anthony Martial, pasi ky i fundit i ka qëndruar afër gruas së tij gjatë procesit të lindjes. Futbollisti francez i është kundërpërgjigjur trajnerit Jose Mourinho, duke i bërë me dije se familja është mbi të gjitha. "Ju falënderoj të gjithëve për mesazhet tuaja. Vogëlushi im Swan është mirë, por për nënën e tij gjërat ishin pak më të vështira. Më vjen keq, por familja ime vjen përpara gjithçkaje", ka thënë Martial.

Vidal, afër Barçës

Arturo Vidal është afër transferimit në skuadrën kampione të La Ligës, Barcelonë. Mediat gjermane raportojnë se mesfushori i Bayern Munchenit ishte afër kalimit në Inter, por 30 milionë eurot e ofruara nga Barcelona kanë ndikuar që drejtuesit "bavarez" të ndërrojnë mendje për shitjen e lojtarit kilian. Vidal në të kaluarën ka luajtur për Juventusin dhe Bayer Leverkusenin.

Neymari rikthehet te PSG-ja

Neymari i është bashkuar skuadrës së Paris Saint-Germainit për ta filluar parasezonin e dytë të tij me kampionin francez. 26-vjeçari kishte arritur dje në Kinë, ku i takoi bashkëlojtarët e tij dhe trajnerin e ri në qytetin e Shenzhenit. Ai i bashkohet skuadrës më vonë se bashkëlojtarët e tij për shkak të pushimit pas pjesëmarrjes në Kupën e Botës.

Rumennigge: Lewandowskin nuk e shesim as për 150 milionë

Bayern Munchen nuk ka ndërmend ta lejojë largimin e Robert Lewandowskit. Shefi ekzekutiv i kampionëve të Bundesligës, Karl-Heinz Rumennigge, është shumë i qartë kur pyetet rreth të ardhmes së sulmuesit polak. "Jemi shumë të kënaqur me të dhe në rolin e tij janë të paktë lojtarët që mund të krahasohen me Lewandowskin. Ne nuk duam ta shesim dhe nuk ka rëndësi nëse dikush ofron 100 apo 150 milionë euro", ka thënë Rumennigge, duke shtuar: "Roberti nuk do të largohet. Mund të them me siguri që ne nuk duam ta shesim. Ai po punon që të largohet nga këtu, por është gjë tjetër çfarë dëshiron ai dhe tjetër gjë çfarë duam ne. Jemi në që vendosim. Ka kontratë të cilën do ta respektojmë për aq kohë sa të jetë e mundur".



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
Одељење за образовање и културу
KOMUNA E GRAÇANICËS
Departamenti i Arsimit dhe Kulturës
Грачаница/ Graçanicë

На основу члана 8. став 1. Закона о раду (Бр.03/3-212) и члана 4. Административног унутства (МРСЗ) Бр.07/2017 за регулисање процедура конкурса у јавном сектору, Одељење за образовање и културу општине Грачаница дана 03.08.2018.године, објављује:

Нë базë тë неит 8 параграфи 1 тë Лигит тë Punës (nr. 03/L-212), dhe тë неит 4 тë Удхëзimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 пëр rregullimin e procedurave тë konkurimit нë секторин publik, Departamenti i Arsimit dhe Kulturës сë Komunës сë Graçanicës, мë datën 03.08.2018. shpall кëтë:

KONKURS KONKURS

1. Назив радног места: Професор географије

Услови:

- Завршен факултет - смер Географија

Број радних часова: 16 недељно
Месечна бруто плата: 367,96 €

Број извршилаца: 1

Период закључења уговора: Пробни рад у трајању од (3 месеца), уз могућност продужења.

1. Titulli i vendit të punës: Profesor i gjeografisë

Кухетет:

- Тë кетë kryer Fakultetin – drejtimi Gjeografia

Numri i orëve: 16 orë në javë
Paga mujore bruto: 367,96 €

Numri i ekzekutuesve: 1

Период е пërfundimit тë kontratës: Puna sprovuese пëр një periudhë prej (3 muaj), me mundësi vazhdimi.

2. Назив радног места: Професор техничког цртања

Услови:

- Завршен технички факултет - смер архитектура

Број радних часова: 16 недељно

Месечна бруто плата: 367,96 €

Број извршилаца: 1

Период закључења уговора: Пробни рад у трајању од (3 месеца), уз могућност продужења.

2. Titulli i vendit të punës: Profesor i vizatimit teknik

Кухетет:

- Тë кетë kryer Fakultetin Teknik - drejtimi Arkitektura

Numri i orëve: 16 orë në javë
Paga mujore bruto: 367,96 €

Numri i ekzekutuesve: 1

3. Назив радног места: Наставник техничког образовања

Услови:

- Завршен технички факултет

Број радних часова: 20 недељно
Месечна бруто плата: 397,51 €

Број извршилаца: 1

Период закључења уговора: Пробни рад у трајању од (3 месеца), уз могућност продужења.

3. Titulli i vendit të punës: Arsimtar i arsimit teknik

Кухетет:

- Тë кетë kryer Fakultetin Teknik

Numri i orëve: 20 orë në javë
Paga mujore bruto: 397,51 €

Numri i ekzekutuesve: 1

4. Назив радног места: Помоћно особље

Услови:

- Завршена средња школа

Број радних часова: 40 недељно
Месечна бруто плата: 272,88 €

Број извршилаца: 3

Период закључења уговора: Пробни рад у трајању од (3 месеца), уз могућност продужења.

4. Titulli i vendit të punës: Staf i ndihmës

Кухетет:

- Тë кетë kryer shkollën e mesme

Numri i orëve: 40 orë në javë

Paga mujore bruto: 272,88 €

Numri i ekzekutuesve: 3

Период е пërfundimit тë kontratës: Puna sprovuese пëр një periudhë prej (3 muaj), me mundësi vazhdimi.

Кандидат мора бити: пунолетан, пословно способан и да није осуђиван за кривична дела која га чине неподобним за вршење посла и за која се изриче казна затвора у трајању од најмање 6 месеци.

Кандидат дует тë jetë: madhor, i aftë пëр punë dhe që тë mos jetë i dënuar пëр vepra penale, тë cilat e bëjnë atë тë papërshtatshëm пëр kryerjen e punës dhe пëр тë cilat mund t'i shqiptohet dënimi me burg në një kohëzgjatje më pak se 6 muaj.

Сваки кандидат уз апликацију прилаже: фотокопију личне карте, оверену фотокопију дипломе, доказ о радном искуству.

Secili kandidat duhet ta paraqet сë bashku me aplikacion: kopjen e letërnjoftimit, fotokopjen e verifikuar тë diplomës, dëshminë e përvojës сë punës.

Конкурс остаје отворен 15 дана од дана објављивања.

Апликације се могу преузети и поднети сваког радног дана у општини Грачаница у периоду од 08:00 до 16:00 часова.

Кандидати могу своје апликације да подносе у периоду од 03.08.2018. до 17.08.2018.године.

Конкурс мбетет и hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Апликационин mund ta marrni dhe ta dorëzoni çdo ditë pune në Komunën e Graçanicës prej orës 08:00 deri në orën 16:00.

Кандидатët mund t'i dorëzojnë aplikacionet e tyre në një periudhë prej 03.08.2018. deri më 17.08.2018.

Напомена: Неблаговремена и некомплетна документација неће бити разматрана.

Вëрејтје: Документациони и dorëzuar pas afatit тë fundit dhe i pakompletuar nuk do тë merret në konsiderim.

Директор:
Drejtoresha:

(м.п)

Shtojca 5: Njoftimi për shprehje të interesit

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Meto Bajraktari" - Reçan

Komuna: Prizren

Data: 03.08. 2018

Emri i kontratës: Shpenzime udhetimi per pjesemarres ne manifestim

Numri i kontratës: ESIP/SDG/087-CS/1.4

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "Meto Bajraktari" – Reçan/Prizren. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i shërbimeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i shërbimeve të nevojshme:

Shpenzime udhetimi per pjesemarres ne manifestim

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e shërbimeve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt termeve të referencës në adresën Adresa e Shkolle SHFMU "Meto Bajraktari" në Reçan, 20530 Reçan - Prizren, më së largu deri më 13.08. 2018.

4. Termet e Referencës së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për propozim do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre konsulentëve potencialë që i plotësojnë kriteret. Konsulentet luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Esad Kurejšepi,
+383 44 389 144,
meto.bajraktari@outlook.com

N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSEVE" SH.A.
FERIZAJ
Nr. 117 Data 02.08.2018


REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVO

Ndërmarrja Publike Lokale
"Stacioni i Autobusëve "Sh.A.
FERIZAJ

Kryeshefi Ekzekutiv i Stacioni Autobusëve Sh.a.Ferizaj në bazë të nenit 16 pika 1 të Statutit të kompanisë, Ligjit të Punës nr.03.L-212 neni 8 dhe 10 pika 2.2 Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe Organogramin , lidhur me plotësimin e vendit të punës shpallë

KONKURS

ME KOHË TË CAKTUAR 1 VJET ME MUNDËSI VAZHDIMI

Për vendin e punës

1.(1) Dispiçer

Kualifikimet e nevojshme:

Kërkesën dhe CV

- Shkolla e mesme
- Aftësi për të punuar në mënyr të pavarur dhe si pjesë e ekipit
- Shkathtësi të shkëlqyeshëm komunikuese
- Shkathtësi të shkëlqyeshëm për kompjuter
- Përovja e punës është e dëshirueshme
- Dëshmi se nuk është nën hetime

Vlerësimi dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim
Lartësia e pagës përcaktohet në harmoni me politikën e Kompanisë
Kandidatët e interesuar mund të marrin aplikacionin në zyrën e kompanisë N.P.L Stacioni i Autobusëve SH.A në Ferizaj dhe po në të njëjtin vend edhe mund ti dorëzojnë aplikacionet.

Dokumentacioni i pa kompletuar nuk do të konsiderohet i vlefshëm.
Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë, pas seleksionimit të dokumentacionit të paraqitur nga komisioni përkatës.
Afati i konkurimit është deri më 10.08.2018

N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A.
Kryeshefi Ekzekutiv

Z. Gazmend Bytyçi

C.nr.69/2017

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, Gjyqtari Ahmet Idrizaj, me zyrtaren ligjore Albana Curri, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses H.C "Jatex" SH.A në Gjakovë, të cilën e përfaqëson i autorizuar Qemajl Juniku, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës SH.P.K "3F" me seli në Gjakovë, e përfaqësuar nga Drejtori Florent Godeni, tani në adresë të panjohur, për borxh, duke vendosur lidhur me propozimin e të autorizuarit të paditëses, që të paditurës t'i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, sipas dispozitës ligjore të nenit 79.3 nën parag.a) dhe b) lidhur me nenin 86 të LPK, me datë 26.07.2018, mori këtë:


AKTVENDIM

Të paditurës SH.P.K "3F", më parë në Gjakovë tani në adresë të panjohur, **I CAKTOHET** përfaqësuesi i përkohshëm Meshari Selimaj, avokat në Gjakovë, i cili ka për obligim që të paditurën në fjalë të e përfaqësojë në procedurën civile në lëndën C.nr.69/2017, sipas padisë të paditëses H.C "Jatex" SH.A në Gjakovë, në çështjen me bazë juridike – borxh dhe atë gjerë në momentin kur e paditura e lartpërmendur përkatësisht ndonjë i autorizuar i saj, nuk lajmërohet në Gjykatë, ashtu që përfaqësuesi i përkohshëm mund të i ndërmerre të gjitha veprimet procedurale për të paditurin në fjalë të paraparë në bazë të Ligjit.

Andaj, luteni që përmbajtjen e këtij Aktvendimi siç është cekur më lartë ta publikoni në Gazetën zyrtare të Kosovës, si dhe në ndonjërin nga të përditshmet ditore dhe lidhur me këtë të e njoftoni Gjykatën. Ky Aktvendim njëherit të publikohet edhe në tabelën e shpalljeve të kësaj Gjykate.

Andaj, Gjykata sipas propozimit të paditëses, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79.3 të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit të lartë përmendur dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.69/2017, datë 26.07.2018

GJYQTARI,
Ahmet Idrizaj



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "FELU CBE KOSOVO", SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 70856158 dhe nr.fiskal: 600815932 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "FELU CBE KOSOVO" D.O.O. od Pristina, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 70856158 i broj fiskala: 600815932 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "FELU CBE KOSOVO", L.L.C. in Prishtina, has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 70856158, i number fiskal: 600815932 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

C. nr. 500/17

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit Franë Gjergj Doqaj nga fshati Osek Hylë komuna e Gjakovës, përfaqësuar nga e autorizuar Feride Zogu nga Gjakova rruga "Nëna Terezë" nr.46, kundër të paditurës Nikoleta Doqaj e vajzërisë Oroshi nga Nju Jorku SHBA, tani me adresë të panjohur, për zgjidhje të martesës me shkurorëzim, me datë 20 korrik 2018, murr këtë:

AKTVENDIM

CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurës Nikoleta Doqaj e vajzërisë Oroshi nga Nju Jorku, SHBA tani me adresë të panjohur, Ilir Hoxhaj avokat Gjakova, rruga "Skënderbeu" pa numër.

